

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7358 E diel 19 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** *i* **Ditës**  
Është gati mbërmje kur mbërrim në Berlin. Pas një tramvaji të shpejtë, i gjithë grupi i shqiptarëve i përzgjedhur nga fondacionet gjermane që merren ...  
Vijon në faqen 21-22

Nga MONIKA SHOSHORI STAFA  
**E humbur në Stasiland**  


**Dje** *në* "Deutsche Welle"  
Si mund të interpretohen fjalët e Shefit të BND-së, Kahl për ambicjet e Moskës? Ishin fjalët të pazakonta të qarta ato që formuloi presidenti i Shërbimit ...  
Vijon në faqen 22

Nga BENJAMIN KNIGHT  
**Rusia: E vlerësuar drejt si rrezik?**



"E vërteta e stërvitjes me britanikët"  
**Dezertimi i 4 komandove në Uells, ish-shefi i Shtabit: Tradhti!**

Jeronim Bazo: Largimi është i patolerueshëm. Raportimi i "The Sun": Rrezikojnë 5 vite burg  
Pas njoftimit nga Ministria e Mbrojtjes për dezertimin e katër pjesëtarëve të Forcave Speciale Komando, ka reaguar ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral Jeronim Bazo, i ftuar në emisionin "Kjo Javë" në "News-24". Ai ka treguar saktësisht çfarë ka ndodhur më 4 ushtarët shqiptarë, duke ...  
Në faqen 6

## INSTITUTI I SIGURIMEVE PUBLIKON MANUALIN: DOKUMENTET E APLIKIMIT

# PENSIONET FAMILJARE, KATEGORITE PERFITUESË

Si përllogaritet masa e pagesës. Përfitojnë prindërit e paaftë për punë, jetimët që studiojnë, bashkëshortët e mbetur të ve që kanë një fëmijë



(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore

**KREU I SHYTIT**  
**Reagimi i Nishanit: Qeveria, sjellje përçarëse në BE, përjashtoi PD**  
Në faqen 2

**EKONOMI**  
**KLSH: Tatimet nuk i mbledhën 1.1 miliardë euro borxh bizneseve**  
Në faqen 5

**BESNIK MUÇO**  
**Gjendet kufoma pranë Leçes, dyshohet për avokatin e zhdukur**  
Në faqen 9

**"FORÇA E LIGJIT"**  
  
**Goditet grupi i prostitucionit, policia sekuestron hotelin në Shkodër**  
Në faqen 10

**MUSXHO** Zbulimi, si u convertua Kristoforidhi në vitin 1857 - Nga dr. David Hosaflook  
**Kush ishte i pari protestant shqiptar?**  
Në brendësi: Poezi të reja nga Preç Zogaj. Përkthyesi, tregim nga Maks Velo

Nga dr. DAVID HOSAFLOOK  
Përvjetori i 500-të i Reformacionit Protestant po kremtohet në të gjithë botën, përfshirë edhe në trevat shqiptare. Në Republikën e Maqedonisë muajin e kaluar u zhvillua një konferencë

**Lutheri e Kristoforidhi**  
Lutheri është themeluesi i Reformacionit Protestant në shekullin XVI. Kristoforidhi është themeluesi i Kishës Ortodokse në Shqipëri në shekullin XVII. Në vitin 1857, Kristoforidhi u convertua në protestantizëm dhe u bë i pari protestant shqiptar. Ky proces u shpreh në një letër që ai shkroi në vitin 1857, ku shprehte dëshirën e tij për të bërë reformime në kishën ortodokse shqiptare. Letërkëmbimet e tij me prijësit e Reformacionit në Evropë tregojnë se ai ishte i ndërgjyeshëm me vlerat e kësaj lëvizjeje. Në vitin 1857, ai shkroi një letër të famshme në të cilën shprehte dëshirën e tij për të bërë reformime në kishën ortodokse shqiptare. Ky proces u shpreh në një letër që ai shkroi në vitin 1857, ku shprehte dëshirën e tij për të bërë reformime në kishën ortodokse shqiptare. Ky proces u shpreh në një letër që ai shkroi në vitin 1857, ku shprehte dëshirën e tij për të bërë reformime në kishën ortodokse shqiptare.



shkencore mbarëballkani-ke për Reformacionin, nën kujdesin e kryetarit të parlamentit, z. Talat Xhaferi. Në Kosovë u zhvilluan disa evenimente me mbështetje të qeverisë së Kosovës, si: një akademi solemne, një simpozium shkencor dhe ...  
Suplement

**PROJEKTI**  
**Bashkia, 2.5 mln euro për pishat në autostradën Tiranë-Durrës**  
Në faqen 4

## SITUATA POLITIKE

### OPOZITA

Përrjashtimi i PD nga takimi i KSA me BE, ish-Presidenti akuzon qeverinë

# Nishani: Qeveria, sjellje përçarëse, Brukseli s'duhet ta kishte lejuar

## "Rama gabon duke izoluar zërin opozitar"

Ish-Presidenti Bujar Nishani akuzoi dje, Partinë Socialiste dhe qeverinë se tregoi një sjellje përçarëse dhe përjashtuese pak ditë më parë duke mos përfshirë Partinë Demokratike, në takimin e radhës së Këshillit të Stabilizimit - Asociimit BE-Shqipëri. Në një koment të tij, në rrjetin social "Facebook", Nishani shkroi dje: "Qeveria aktuale e kishte përjashtuar kontributin e opozitës nga kjo tryezë! Padyshim që kjo shënon një tjetër sjellje përçarëse dhe përjashtuese me forcën e pushtetit ndaj të drejtës përfaqësuese të gjysmës së popullsisë në një proces që mund të jetë veçse gjithëpërfshirës. Por, kjo sjellje e qeverisë shqiptare nuk duhet të ishte lejuar nga mikpritësit në Bruksel. Komisioni duhej ta kishte dekurajuar qeverinë shqiptare në gjestin e saj përjashtues ndaj opozitës". Realiteti i sotëm ku ish-stalinstët shqiptarë ulen në tryezën e familjes perëndimore si partnerë është vërtetë një mrekulli e demokracisë, por kjo nuk mund të justifikojë përjashtimin nga ajo tryezë të atyre që e rrëzuan diktaturën në Shqipëri dhe e anëtarësuan atë në NATO, vetëm për faktin se aktualisht janë në opozitë dhe nuk kanë fuqinë e vendimmarrjes ekzekutive", u shpreh ish-Presidenti. Sipas tij, "Integrimi i Shqipërisë në BE është një çështje jetike. E për ta realizuar atë duhet kaluar përmes një procesi që do të jetë i gjatë. Do të jetë i gjatë dhe i vështirë. Kjo vështirësi nuk duhet adresuar si faji i popullzimit të majtë apo urrëjtës së ekstremit të djathtë në Evropë. Ne nuk kemi asnjë mundësi të ndikojmë tek ato. Por ne mund të ndryshojmë veten tonë. Ne mund të ndryshojmë funksionimin e institucionëve të shtetit duke i kthyer në modelin evropian ato". "Ne mund të vendosim normalitetin e proceseve elektorale në Shqipëri ku zgjedh qytetari në liri dhe jo ta përcaktojë trafikantët e drogës. Ne mund ta bëjmë realitet edhe në Shqipëri modelin e "ligji i barabartë për të gjithë". Ne mund ta luftojmë realisht krimin e organizuar dhe korrupsionin ashtu si dhe në Evropë. Ne mund t'i adresojmë resurset ekonomike të vendit të pros-

perimi i qytetarëve, etj., etj. Këto do mund të bëhen vetëm përmes angazhimit të opozitës", propozon ish-presidenti në komentin e tij. "Qeveria shqiptare përpara se të përjashtojë zërin dhe kontributin e opozitës nga procesi i stabilizimit, ju

detyrohet t'u thotë shqiptarëve përse ka dy qëndrime në Bruksel për procesin integruar të Shqipërisë. Komisioni, nga njëra anë, që ka konsideruar kushtet e plotësuar për hapjen e negociatave dhe Këshilli Evropian (vendet

anëtare), nga ana tjetër, që kërkon plotësimin e kriterëve", u shpreh Nishani. Sipas tij, "Në nëntor të vitit 2016 Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave me Shqipërinë. Në raport thuhej: "Komisioni jep një rekomandim të kushëtuar sa i takon hapjes së negociatave me Shqipërinë". Por në Samitin e dhjetorit 2016 Këshilli Evropian (vendet anëtare) refuzoi të mbështeste rekomandimin e Komisionit". "Nëse qeveria shqiptare tinëzish mendon se duke izoluar zërin opozitar në adresimin e sfiadave dhe rreziqeve që has procesi i integritetit të Shqipërisë, do t'i fshehtë këto rreziqe, është duke gabuar. Asnjë gjest i stisur nuk kompenzon dot kontributet lëvizëse", tha Nishani.



Ish-Presidenti Bujar Nishani

Kryetari i PD-së i ankohet NDI: Krimi po asgjëson reformat

## Lulzim Basha: Të krijohet një qeveri antimafia në Shqipëri

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha u tha dje, përfaqësuesve të Institutit Demokrat Amerikan (NDI) se zgjidhja për situatën e rënduar në Shqipëri është krijimi i një qeverie antimafia. Basha ndau shqetësimin për situatën e rëndë politike pas publikimit të fakteve për lidhjet e qeverisë me trafikun ndërkombëtar të drogës, që provuan se kanabizimi i vendit ishte një projekt politik dhe elektoral i Edi Ramës. "Ndërlidhja e krimi i me politikën rrezikon të komprometojë rëndë gjithçka ka arritur Shqipëria në këto vite, si edhe të asgjësojë çdo reformë për zhvillimin e vendit", tha Basha në takimin me delegacionin e NDI, i drejtuar nga Robert Benjamin, drejtor për Europën Qendrore dhe Lindore. Kryetari i PD thek-



Kryetari i PD-së Lulzim Basha, dje me përfaqësues të Institutit Demokrat Amerikan (NDI)

soi se zgjidhja për këtë situatë të rëndë politike është krijimi i një qeverie antimafia për të bërë të mundur qmuntimin e sistemit mafioz politik të ngritur mbi blerjen e votës. "Për këtë qëllim, tha Basha - zbatimi i identifikimit biometrik dhe votimi i elektronik, si dhe kontrolli i financimit të rreptë të partive, është domosdoshmëri jetike për zgjedhje sipas standardeve demokratike". Delegacioni i NDI-së është në Tiranë për t'u ofruar par-

tive politike asistencë për transparencën, menaxhimin dhe mbikëqyrjen financiare. PD është e gatshme ta zbatojë këtë përvajë, por zoti Basha shprehu shqetësimin e përdorimit të parave të pista në fushatë, siç është faktuar nga përgjimet e antimagjias italiane se Saimir Tahiri shpenzoi 20 milionë euro, të ardhura nga trafiku i drogës, për fushatën e PS-së në Tiranë, në zgjedhjet e fundit.



Presidenti i vendit, Ilir Meta dje në takimin vjetor me ambasadorët e Shqipërisë në botë

### DEKLARATA E PD

Një ditë më parë, PD deklaroi se ishte përjashtuar nga takimi i Këshillit të Stabilizimit - Asociimit BE-Shqipëri. Përfaqësuesi i tyre, kreu i Komisionit parlamentar të Integritetit, Genc Pollo nuk ishte ftuar në këtë takim të rëndësishëm dhe PD e cilësoi këtë "frikë" nga e vërteta e kriminalizimit të shtetit.



Taulant Balla takon drejtorin e NDI

## Një delegacion i PS së shpejti në Uashington për marrëveshje bashkëpunimi

Në cilësinë e sekretarit të përgjithshëm të Partisë Socialiste, Taulant Balla njëherësh edhe kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së u takua dje, me drejtorin për Europën Qendrore dhe Lindore të Institutit Demokratik amerikan NDI zotin Robert Benjamin dhe drejtorin e Programeve të Partive Politike të NDI në Washington, zotin Ivan Doherty. Partia Socialiste e Shqipërisë prej 15 vitesh ka një bashkëpunim shumë të ngushtë me Institutin Demokratik amerikan dhe ne vlerësojmë maksimalisht asistencën dhe këshillimin e ekspertëve të NDI në përgatitjen e drejtuesve të rinj dhe në rritjen e transparencës së financimit të partive politike. Në takimin e zhvilluar me drejtuesit e lartë të Institutit Demokratik në Uashington fakti që Partia Socialiste ka standardin më të lartë të transparencës financiare në Shqipëri, bazuar në një strukturë auditimi tërësisht të pavarur dhe profesionale. Shumë shpejt një delegacion i Partisë Socialiste do të vizitojë zyrrat qendrore të Institutit Demokratik amerikan në Uashington për të diskutuar dhe nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi mes PS dhe NDI, bëri të ditur dje, Taulant Balla.



Presidenti flet para ambasadorëve: Vizat, BE dhe Shengen na monitorojnë

# Meta: Të bëjmë më shumë, të përmirësojmë klimën e biznesit

"Viti i Skënderbeut, një mesazh bashkimi afatgjatë"

Darina Tanushi

Presidenti vendit, Ilir Meta vlerësoi dje, si objektivin madhor kombëtar, anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Gjatë fjalës që mbajti në takimin vjetor me ambasadorët e Shqipërisë në botë, që u mbajt në "Tirana Business Park" me temë "Diplomacia Ekonomike", Presidenti nënvizoi se "Do të bëjmë përpjekje të mëdha për të demonstruar përparim të qëndrueshëm në të pesë prioritetet, në mënyrë të veçantë në zbatimin e reformës në drejtësi, arrijtjet të cilat do t'ua bëjnë edhe ju punën më të lehtë në vendet ku përfaqësoni vendin për të kërkuar më shumë mbështetje nga vendet anëtare, sidomos të Bashkimit Evropian për këtë moment". Meta tha se diplomacia kulturore duhet të jetë në shërbim të diplomacisë ekonomike. "Padyshim diplomacia ekonomike është tepër e rëndësishme, por në mënyrë të veçantë do të theksoja që është e domosdoshme për ne të bëjmë një progres më të madh për përmirësimin e klimës së biznesit dhe për të tërhequr investitorë sa më të besueshëm", u shpreh Presidenti. "Por, vijoi Meta, sidomos është e theksoj se këtu vendimtare mbetet puna që ne do të bëjmë brenda vendit për të përmirësuar akoma edhe më tej klimën e biznesit, ashtu sikurse jam i bindur që ju do të vazhdonit të bëni gjithçka për të promovuar turizmin, produktet e vendit tonë dhe për të rritur interesin e investitorëve të ndryshëm drejt Shqipërisë."



Presidenti vendit, Ilir Meta

**ARBEN AHMETAJ**  
Ministri i Ekonomisë dhe Financës Arben Ahmetaj tha se është e rëndësishme kalimi në një fazë të re të diplomacisë ekonomike, e cila lidhet me promovimin e Shqipërisë për përfitim dhe sa më shumë investitorëve të huaj. Sipas tij, statistikat tregojnë se investimet e huaja kanë kapur vlerën e 1.1 miliardë euro.

**DAMIAN GJIKNURI**

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjicknuri u shpreh se vendi ynë ka potencial të madh në sektorin energjetik dhe atë mineral. Vepra të mëdha energjetike po ndërtohen dhe të tjera janë në zhvillim. Duhet të jetë e rëndësishme thithja e investimeve në fushën e gazit, duke u bazuar edhe në ndikimin që projekti TAP pati në ekonominë shqiptare.

**Ervin Bushati: Bashkëpunim rajonal për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE**

Partitë e Majta të Ballkanit u mbledhën këto ditë, në Sarajevë për të diskutuar rreth situatës në vendet që aspirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Partia Socialiste u përfaqësua në këtë takim nga deputetët Ulsi Manja, Ervin Bushati, Jurgis Çurbja si dhe drejtoresha e Hipotekave, Blerina Doracaj e kreu i FRESH, Eljo Hyskaj. "Në Samitin Rajonal të Liderëve të Partisë Socialiste Evropiane (PES), mbi rritjen e bashkëpunimit rajonal si dhe integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE, Nevoja e vazhdueshme për dialog produktiv me qëllim zbatimin e masave të përbashkëta të integritimit ekonomik, forcimit të shtetit social, modeleve të reja dhe konkurruese të taksimit, si dhe investimit në arsim, kërkimit shkencor dhe zhvillimit përfaqësojnë disa nga prioritetet në misionin e vazhdueshëm të partive të majta në këtë zonë", shkroi dje, në një status në "FB", deputeti socialist Ervin Bushati. Edhe deputeti tjetër Çurbja ka sqaruar takimet që delegacioni i PS-së ka pasur atje me miqtë e Shqipërisë raportuesin Knut Fleckenstein dhe eurodeputetën Tanja Fajon, si dhe drejtues të të majtës në rajonin tonë, me të cilët u ndanë bindjet e unifikuar se rruga e Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit, është Bashkimi Evropian.



**Kreu i KQZ, Komisioni i Ligjeve shqyrton kërkesën e PS për shkarkimin e Zgurit**

Komisioni parlamentar i Ligjeve pritet të marrë në shqyrtim javën që vjen, kërkesën e Partisë Socialiste për shkarkimin e kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kryetari i Kuvendit ia ka dorëzuar dokumentin në fjalë kreut të Komisionit të Ligjeve dhe në fillim të javës, ai pritet të vendoset në kalendarin e punimeve të tij. Ky komision ka 4 javë kohë për të dalë me një raport lidhur me kërkesën e socialistëve dhe më pas raporti në krye të 3 javëve duhet të kalojë për votim në seancë plenare.



Për rastin e shkarkimit të kryetarit të KQZ nevojitet një shumicë e thjeshtë parlamentare. Klement Zguri u

zgjodh në krye të KQZ në bazë të marrëveshjes Rama - Basha dhe socialistët thotë se ai nuk e justifikon qëndrimin në atë detyrë, sa kohë që sipas tyre, ai shkel ligjin duke mos e shqyrtuar kërkesën e prokurorisë për kryebashkiakun e Mallakastrës, i cili preket nga ligji i dekriminalizimit. Kryeministri ka lajmëruar se ka nisur procedurat e shkarkimit dhe për vetë kryebashkiakun demokrat të Mallakastrës, i cili është dënuar me dy vjet burg për një vjedhje në Itali.

Gjë e nuk është zgjidhje, jo për shkak të mungesës së dëshirës sonë, por për shkak se ne vetë jemi nënë monitorim për çështjen e liberalizimit të vizave nga vendet e Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen, dhe çdo veprim emocional jo vetëm që nuk do të zgjidhte çështjen e lëvizjes së lirë të qytetarëve të Kosovës, por do të bllokonte edhe lëvizjen e lirë të qytetarëve të Shqipërisë", u shpreh Meta. Presidenti vlerësoi shqiptarët jashtë atdheut, si një potencial i jashtëzakonshëm në dobi të përmirësimit të imazhit dhe ekonomisë së Shqipërisë. "Shqiptarët jashtë janë një potencial

shumë i madh se sa shqiptarët brenda për arsye se për fat të keq, dhe të marrim anën e mirë, një nga pjesët më vitale dhe më të kualifikuara të shoqërisë sonë sot ndodhet jashtë vendit dhe ky natyrisht është një problem për resurset njerëzore sot në vend, por është edhe një avantazh për t'u pasur në konsideratë se shumë prej tyre janë shumë të suksesshëm e të integruar dhe kanë mjaft ndikim në vendet ku ata sot jetojnë", tha kreu i shtetit. Ai vlerësoi edhe krijimin e Ministrisë së Diasporës nga kryeministri Rama. Sipas Metës, "Viti që vjen është viti i Skënderbeut, është një mo-

ment shumë pozitiv për t'i bashkuar të gjithë shqiptarët". Ky vit, sipas Presidentit duhet të japë "një mesazh bashkimi jo vetëm për një vit, por në perspektivë, në një plan më afatgjatë". "Shpresojmë që shpërbliimi më i mirë të jetë çelja e negociatave vitin e ardhshëm me Bashkimin Evropian, pasi këtu është përqendruar objektivit ynë kryesor afatshkurtër, që lidhet me atë afatgjatë: anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Sigurisht që kjo nuk varet vetëm nga ne, por ne do të lehtësojmë punën tuaj këtu dhe punën e të gjitha vendeve që janë por zgjerimit", u shpreh Meta.

**EPSA SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**  
SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

1- "Arae-Truall" me sipërfaqe 582 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 112.2 m<sup>2</sup>, dhe ndërtesa 112.2 m<sup>2</sup>. Nr Pasurisë 61/241, ZK:1298, Volum.17, Fage.87, e ndodhur në Bucinas, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tirana Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **110.800 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **11.12.2017 ora 16.00** në adresën Rr." Qemal", Pall."Fratar", K.6.Tirane.

2- "Truall" me sipërfaqe 3.942 m<sup>2</sup>. Nr Pasurisë 731/45, Zona Kadestrale: 26/48, VOLUM.7, Fage.110, e ndodhur në Memelisht, Pogradec. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Tirana Bank sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **59.602 Euro**. Ankandi zhvillohet datë **11.12.2017 ora 16.00** në adresën Rr."1. Qemal", Pall."Fratar", K.6.Tirane

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 22627111 ose ne [www.epsa.al](http://www.epsa.al)

Vendimi, zëvendësohen palmat në segmentin nga mbikalimi i Kamzës deri tek ai i Kasharit


# Bashkia e Tiranës, 2.5 mln euro për të mbjellë pisha në autostradë

## Për këtë investim janë pakësuar fonde në projekte të tjera

Bashkia e Tiranës planifikon të zëvendësojë deri në fund të këtij viti palmat në segmentin e autostradës Tiranë-Durrës, nga mbikalimi i Kamzës deri tek ai i Kasharit, me pisha. Këtë e vërteton relacioni i siguruar nga "News 24" për disa ndryshime dhe rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e Bashkisë së kryeqytetit për vitin 2017, që pritet t'i dërgohet Këshillit Bashkiak. "Gjatë periudhës që sapo kaloi me thatësi të pazakonte, bimësia dekorative (palmat e mbiella) nuk u përshtatën me kushtet klimatiko-tokësore të Tiranës, kësaj nuk i mbijetuan zhvillimit të ciklit të tyre jetësor", thuhet në relacimin.

Për këtë arsye propozohet që në vend të palmave të mbillen lloje dekorativësh të pishës së butë, që përshtaten me klimën dhe mjedisin. Po ashtu, në propozim thuhet se "DPNR propozon që në vend të palmave gjatë këtij segmenti rrugor të mbillen lloje dekorative me pishë të butë që përshtaten me klimën dhe mjedisin. Mbjellja e pishës së butë në të dyja anët përgjatë autostradës do të krijojë kushte për amortizimin e zhurmave të krijuara nga trafiku i rënduar si dhe do të ulë ndjeshëm nivelin e ndotjes së mjedisit", thuhet në relacimin.

"Duke qenë se periudha më e mirë për mbjelljen e pishës së butë është dhjetori, kërkohet përfshirja në buxhet e këtij investimi. Bazuar në vëzhgimet aktuale të ujtitjes së sipërfaqes së barit, drurëve, shkurreve në këtë segment autostrade propozohet futja e sistemit ujtitës artificial në formë shiu. Drejtorja e Përgjithshme nr.1 e punëtorëve të qytetit me shkresën nr. prot. 40547 datë 06.11.2017 si dhe Drejtorja e Përgjithshme e Punëve Publike me shkresën nr. prot. 40759, datë 07.11.2017 na njofton në lidhje me këtë situatë dhe masat që duhet të ndërmerren, vijon relacioni. "Për të bërë të mundur shkrimin e këtij investimi në buxhet janë pakësuar fonde në ato artikuj ku është vënë re një realizim 10 mujor më i ulët nga planifikimi. Pakësimi i fondeve është propozuar kryesisht në projektet për të cilat ka pasur diferencë nga fondet i parashikuar me vlerën e kontratës së lidhur", sqarohet në këtë dokument. Kostoja e plotë e projektit "Furnizim dhe vendosje drurë dekorativë në zonën industriale Kamzë-Kashar", që propozohet të përfshihet në buxhet, është 333.8 milionë lekë, ose gati 2.5 milionë euro. Ajo është e ndarë në tri vjet dhe e shpërndarë



Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, në një reagim të tij, dje, për vendimin për të ndërruar palmat në autostradë me pishat e buta, akuzon kryeministrin si përgjegjës për gjithçka ndodh. Sipas tij, do të harxhohen 2.5 milionë euro për të zëvendësuar palmat e thara me pisha. "Kryeministri i kazonit të trafikantëve i mbrojti fort palmat, me pasion prej trafikanti dhe me humor prej gasteri të decerebruar. Sot na kërkojnë 2.5 milionë euro të tjera për të zëvendësuar palmat e thara me pisha", shkroi dje, në rrjetin social, kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili. "Kryeministri rropi paratë e palmave në autostradë, tani do rrjepë të pishave. Sa turp! Qindra milion lekë palma në autostradën Tiranë - Kashar u thanë, u asgjësuan, iu vodhën njerëzve

### Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së akuzon kryeministrin për vjedhje

## Petrit Vasili: Rama rropi paratë e palmave, tani kërkon edhe të pishave



të thjeshtë. Specialistë, media, shoqëri civile, politikanë e argumentuan tërësisht që kjo është vjedhje e ndryrë ditën për ditël" - u shpreh Vasili, ndër të tjera. "Kryeministri i kazonit të trafikantëve i mbrojti fort

palmat, me pasion prej trafikanti dhe me humor prej gasteri të decerebruar. Sot na kërkojnë 2.5 milion euro të tjera për të zëvendësuar palmat e thara me pisha. A ka turp ky kryeministër? Apo e ha turpin me

"Kryeministri i kazonit të trafikantëve i mbrojti fort palmat me pasion prej trafikanti dhe me humor prej gasteri të decerebruar. Sot na kërkojnë 2.5 milionë euro të tjera për të zëvendësuar palmat e thara me pisha"

në 66.7 milionë lekë në 2017-n, 117 milionë lekë në 2018-n dhe 150 milionë lekë në 2019-n. Kujtojmë që palmat u mbollën në autostradë rreth tre vjet më

parë, si pjesë e një plani që përfshiu dhe rregullimin e sinjalistikës në zonën Mbikalimi i Kamzës dhe i Kasharit deri në aeroportin e Rinasit. Kos

to e mbjelljes së tyre u raportua rreth 1 milionë euro, ndërsa opozita e cilësoi atë si një projekt të pastër korruptiv, duke shigjetuar shpe-

shërë kryeministrin Edi Rama. Bashkia thekson se kjo arterie rrugore do të ridentifikohet dhe do të sjellë një pamje krejtësisht të re.

Deputetja e PD-së, Alba Na Vokshi e akuzoi dje, kreun e qeverisë Edi Rama se ka favorizuar me "check up"-in mikun e tij Vilma Nushi. Në një dalje për mediat, Vokshi tha se qeveria i ka dhënë biznesit që ka marrë shërbimin e ekzaminimit shëndetësor 4 milionë euro për rreth 250 mijë analiza që nuk janë bërë asnjëherë dhe do të vazhdojë t'i japë edhe 7 milionë të tjera. "Check up" është më korruptiv, sepse vetëm për dy vitet e para të koncesionit të check up-it, pa përfshirë 2017-ën, klientja e Edi Ramës, Vilma Nushi, ka marrë nga buxheti i shtetit rreth 4 milionë euro për rreth 250 mijë analiza të pabëra asnjëherë. 1.7 milionë euro në 2015-ën dhe 2.3 milionë euro në 2016-ën, siç tregohet edhe në tabelën e Fondit të Kujdesit Shëndetësor", - u shpreh Vokshi. "Ky përfitim marramendës është parashikuar në kontratën e Edi Ramës me klienten e tij Vilma Nushi, e cila do të vazhdojë të paguhet 7 milionë euro në vit, edhe sikur check up-in ta kryejë një shqiptar i vetëm. Kjo është arsyeja pse Edi Rama prej dy vjetësh refuzon ta bëjë publike këtë kontratë zhvatëse për shqiptarët, si dhe çdo kontratë tjetër koncesionare në shëndetësi", - tha ajo. Vokshi denoncoi se për 4 miq biznesmenë të kryeministrit, buxheti parashikon rreth 40 milion euro dhe i bën thirrje prokurorisë speciale që do të krijojhet me reformën e re të drejtësisë të hetojë mbi këto afëra.

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me permbartues Enuar Merko me adresë Rre Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tirane, Njesia 10 njofton se me date 01.12.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III për shitjen e pasurisë të palushme Apartament me sipërfaqe totale 61.5 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 90/1994-2, volumn 20, faqe 154, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Mirir Arif Ruga dhe Zy.Servete Behxhet Ruga me vlerë fillestare në ankand 12.990 (Dymbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) EURO dhe Apartament me sipërfaqe totale 56.5 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 90/1994-4, volumn 20, faqe 163, zona kadastrale 1791 me adresë Golem, Kavajë në pronësi të Z.Mirir Arif Ruga dhe Zy.Servete Behxhet Ruga me vlerë fillestare në ankand 11.291 (Njëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, email enuar.merko@gmail.com

**SHPALLJE ANKANDI**  
Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me permbartues Enuar Merko me adresë Rre e Bogdaneve, Pall 15, Kati 2, Tirane, Njesia 10 njofton se me date 28.11.2017 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i I për shitjen e pasurisë të palushme Apartament me sipërfaqe totale 65 m<sup>2</sup>, regjistruar në Z.A.R.P.P Tiranë me Nr pasurie 1/154-1-4, Vol.7, Faq.247, Zk.8350 në pronësi të Z.Lirim Petri Kocaj, Petref Hito Kocaj, Fato Mejdjo Kocaj, Altin Petref Kocaj, Agron Petref Kocaj dhe Etleva Xheladin Kocaj me vlerë fillestare në ankand 39.000 (Tridhjetë e nëntë mijë) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580 , email enuar.merko@gmail.com

**NJOFTIM PER SHITJE**  
Ne Zyren e Permbartuesit Gjyqesor Arjan Palla me adresë Blv.Zogu i I-re, Pall.Agimi, H-2-K-3, Ap.-5-Tirane me dt. 20.11.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë me nr. 1/197 +3-26, vol.8, fq.48, z.k 8260, lloji i pasurisë apartament me sip. 73 m2 ndodhur ne Tirane, rregjistruar ne pronesi te Fazile Stafa. Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 28405,2 Euro.

Mbledhja me forcë e tatimeve dhe kamatave, dosje të veçanta për çdo rast

Ornela Manjani

# Borxhi i bizneseve, KLSH: Tatimet nuk mblodhën 1.1 miliardë euro

*Detyrimet e prapambetura, 140 mijë biznese janë debitorë*

Kontrolli i Lartë i Shtetit bën përgjegjësi administratën tatimore për rritjen e madhe të borxheve, që bizneset kanë ndaj shtetit. "Drejtoria e Tatimeve nuk ka mundur të vjelë detyrimet e paguara nga subjektet tatimpaguese, pasi nuk ka krijuar kushtet për zbatimin e ligjit", thuhet në vlerësimin e KLSH-së. Sipas të dhënave zyrtare, në fund të vitit të kaluar, borxhi i bizneseve në shtet për taksat e paguara, përfshirë gjobat dhe kamatëvesat arrihi në 1.1 miliardë euro. Krahasuar me vitin 2011, detyrimet e paguara të bizneseve në shtet janë rritur me 2.2 herë. KLSH thotë se shkaku kryesor është administrata fiskale, e cila jo vetëm që nuk e ka parandaluar krijimin e këtij borxhi, por as nuk ka qenë efektive në mbledhjen e tij. "Administrata Tatimore nuk ka arritur të menaxhojë detyrimet tatimore të paguara në afat dhe të zbatojë me efektivitet masat shtrënguese për mbledhjen e tyre", vijon më tej vlerësimi i KLSH-së.

## DEBITORËT

Aktualisht numërohen mbi 140 mijë biznese debitorë në shtet, pjesa më e madhe e borxheve i përket një grupit të vogël kompanish. Sipas KLSH-së, tolerimi i tyre ka dëmton buxhetin e shtetit, por edhe qytetarët. Shifra prej 1.1 miliardë eurosh të borxheve që biznesi ka në shtet është e barabartë me gati 10 për qind të prodhimit kombëtar. "Sektorët e mbledhjes me forcë të kri-



jojnë dosje të veçanta për subjektet që rezultojnë pa procedura dhe fillimin menjëherë të tyre, si dhe kompletimin e të gjithë dosjeve të tjera me dokumentacionin ligjor. Administrata Tatimore duhet të intensifikojë aktivitetet në futjen e masave parandaluese, të cilat duhet të kenë ndikim në lindjen e borxhit tatimor në

përpunje me praktikën pozitive të organeve tatimore të vendeve të zhvilluara"-thuhet në rekomandimet e KLSH-së.

## RAPORTI

"Gjendja e detyrimeve tatimore të paguara në fund të vitit 2016 është 147 miliardë lekë dhe paraqitet me një rritje e ndjeshme, në masën 45.5 %, krahasuar me një vit

## MBLEDHJA ME FORCË

Funkcioni i mbledhjes me forcë kryhet nga 14 Drejtoritë Rajonale Tatimore, nga të cilat në 7 prej tyre, mbledhja me forcë është organizuar si drejtori dhe në 7 DRT si sektor. Nisur nga gjendja e detyrimeve të paguara, sipas statusit të tatimpagues, konstatohet se subjektet e evidencuara si pasive, të cilat nuk ushtrojnë aktivitet ekonomik prej një kohe të gjatë, zënë rreth 37 %, peshë e madhe kjo në gjendjen e këtyre detyrimeve dhe që mundësitë për t'i mbledhur këto detyrime janë shumë të vogla, duke e kthyer këtë në një borxh të pa mbledhshëm.

## ARKËTIMI I DETYRIMEVE

Arkëtimi i detyrimeve të paguara nga masat shtrënguese është në total 38.4 miliardë lekë për periudhën 2011-2016, ku nga këto 13 miliardë lekë janë arkëtuar vetëm në vitin 2016. Në vitin 2015 janë arkëtuar 5.8 miliardë lekë, në vitin 2014 janë arkëtuar 7.2 miliardë lekë, në vitin 2013 janë arkëtuar 5 miliardë lekë, në vitin 2012 janë arkëtuar 4 miliardë dhe në vitin 2011 janë arkëtuar 2 miliardë lekë. Nga auditimi rezultoi se për periudhën e viteve 2011 - 2016 për masat shtrënguese janë mbledhur nga 12 deri 31% të vlerës së masave të vendosura.

znesave, të cilat kanë këto detyrime; në fund të vitit 2016 numri i këtyre bizneseve arrihi në 146,650 nga 79,785 që ishin në vitin 2011, me një shtim rreth 1.8 herë"-thuhet në raportin e KLSH-së. "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka mundur të vjelë detyrimet e paguara nga subjektet tatimpaguese, pasi nuk ka krijuar kushtet për zbatimin plotësisht të kuadrimit ligjor në fuqi lidhur me detyrimet tatimore; strukturat e mbledhjes me forcë nuk kanë zbatuar rregullisht metodën e vlerësimit të riskut dhe nuk kanë kryer monitorimin e kontrollin e duhur ndaj drejtorive rajonale tatimore të kësaj veprimtarie të rëndësishme, për realizimin në praktikë të procedurës së sekuestrimit e më pas konfiskimit ndaj subjekteve tatimpagues me detyrime, si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore ka qenë i pjesshëm, duke ulur ndjeshëm efektivitetin e veprimtarisë së administratës tatimore qendrore në zbatimin e masave ligjore shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore të paguara në afat."-thekson raportin

më parë, ndërsa të ardhurat gjithsej të realizuara nga DPT për këtë vit janë 214.6 miliardë lekë. Gjatë v. 2016, Administrata Tatimore Qendrore ka pësuar një shtim rekord të detyrimeve tatimore të paguara në afat, tregues ky i menaxhimit jo të mirë të këtyre detyrimeve nga administrata tatimore. Në vlerën e detyrimeve të

paguara prej 146 miliardë lekë është e përfshirë edhe vlera prej 37 338 milion lekë e 541 subjekteve që janë në proces gjyqësor. Ndërsa krahasuar me v. 2011 gjendja e detyrimeve të paguara në fund të v. 2016 është 2.2 herë më e madhe. Përveç shtimit të detyrimeve të paguara në vlerë kemi edhe rritje të ndjeshme të numrit të bi-

## Sfidat e auditimit në Shqipëri

### Qato: Raportimi financiar, përgjegjësi për integrimin në BE

Profesioni i audituesit në Shqipëri bën 20 vjet dhe ndeshet në vazhdimësi me sfida në një ambient ekonomik në ndryshim të vazhdueshëm. IEKA ka zhvilluar konferencën e IV ndërkombëtare, e cila synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e raportimit financiar. Këtë konferencë e ka përshëndetur edhe ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Sonila Qato. Puna e audituesit po përballon me sfida të mëdha dhe përgjegjësi në një kohë kur vendi synon integrimin në BE sipas Qatos. "Duke promovuar transparencën dhe nevojën për respektimin e barabartë të ligjit, profesioni i audituesit mund të ndihmojë shumë, veçanërisht për të garantuar suksesin e luftës ndaj informalitetit. Sfidat e integrim-

it - Puna që duhet të bëjmë për t'u integruar në Bashkimin Europian, kërkon angazhimin e të gjithë faktorëve dhe padyshim profesioni juaj do të dijë të orientojë drejt duke kontribuar në këtë proces kaq të rëndësishëm." Presidenti i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Hysen Çela si dhe sekretari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave Anastas Angjeli u ndalën në rëndësinë që ka ky profesion sa i përket raportimeve të sakta financiare. "Auditimi vijon të mbetet edhe sot në axhendë në shumë vende të botës, pasi përfitimet që rrjedhin prej tij janë të dëshiruara jo vetëm për bizneset, por edhe për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Në kushtet e reja rëndësi parësore merr rikonsiderimi i rolit, në mënyrë që profesioni i audituesit të jetë jo vetëm në pajtim me kërke-



Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Sonila Qato

sat e reja ligjore e rregullatore, por edhe me zhvillimet e vullshme në teknologjinë e informacionit, të cilat kërkojnë një transformim drejt një profesioni të dixhitalizuar."-thotë Qato. Në konferencë u diskutua mbi rëndësinë e dixhitalizimit dhe përdorimit të teknologjisë si dhe nevoja për diversifikimin e shërbimeve dhe shtimit të cilësisë. Një tjetër pikë me interes ishte edhe përmirësimi i edukimit, duke e vlerësuar si faktor kyç për suksesin e profesionit kontabël.

## Konfindustria thirrje qeverisë për reformat

### Reforma në drejtësi do të prodhojë rritje ekonomike

Konfindustria vlerëson, se reforma në drejtësi do të prodhojë pasojë mjaft të fuqishme në zhvillimet thelbësore të ekonomisë shqiptare afatgjatë. Vendimarrja politike duhet, që në një kohë sa më të shpejtë, të analizojë ndikimin shumëpërmasor të reformës në drejtësi në ekonominë vendore dhe mirëqenien e qytetarëve shqiptarë si dhe të përpunojë strategjinë përkatëse balancuese. Konfindustria vlerëson, se pasojat e para në treguesit ekonomik të ndikimit të reformës së drejtësisë dhe procesit të afërm të vetingut, kanë filluar të shfaqen. Mbiçmimi i qëndrueshëm i lekur kundrejt euros për një kohë të gjatë në vitin fiskal 2018 krahasimisht viteve parardhëse në kushtet kur treguesit makroekonomik formalë nuk e përligjin,



Foto ilustruese

rritja e shpejtë e kërkesës për investime private në sektorin e ndërimit dhe infrastrukturës krahasuar me kahjen e ulët të kërkesës për kredi bankare, rritja e pranisë së financimeve me burime të origjinës së kapitalit nga të ashtuquajturat paraajsa fiskale në koncesione dhe licencime, etj. mund të shpjegohen vetëm me përfundim-

min e mësipërm. Arsyet tjetër madhore e ndikimit të fuqishëm, që reforma në drejtësi do të ketë mbi ekonominë shqiptare, është përqindja mjaft e lartë e informalitetit prej të paktën 40% në PPB të vendit. Konfindustria vlerëson, se vendimarrja politike shqiptare duhet, që krahas ndërtimit sa më të shpejtë të strategjisë ekonomike balancuese, është e domosdoshme të kërkojë dhe rritjen e ndjeshme të kontributit financiar të shteteve mike, që duhet të përkohë në kohë dhe sasi me thellësinë dhe shtrirjen e zbatimit të reformës në drejtësi. Në rast të kundërt, pasojat ekonomike të reformës në drejtësi, mund të prodhojnë në periudhë afatmesme, falimentim masiv të bizneseve, rritjen e shkajshme të papunësisë, uljen e nivelit të jetesës së qytetarëve dhe prodhim valësh të mëdha emigratore.

Ja çfarë ndodhi me katër ushtarët në Mbretërinë e Bashkuar, si e braktisën detyrën

# Dezertimi i Komandove, ish-shefi i SHPFA: Akt tradhtie!

Jeronim Bazo: Largimi është i pajustificueshëm dhe i pa tolerueshëm

**P**s njoftimit nga Ministria e Mbrojtjes për dezertimin e katër pjesëtarëve të Forcave Speciale Komando, ka reaguar ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral Jeronim Bazo, i ftuar në emisionin "Kjo Javë" në "News-24". Ai ka treguar saktësisht çfarë ka ndodhur me 4 ushtarët shqiptarë, duke theksuar se largimi i tyre nuk është një fenomen, pasi ka pasur raste të tilla më herët, por jo vitet e fundit. "Ka qenë një periudhë kur vërtetë SHBA-të ishin një shënjestër joshëse dhe kemi pasur probleme nga fundi i viteve '90, fillim i viteve 2000, sidomos kur dërgonim ekupe të mëdha për t'u stërvitur së bashku me partnerët. Kurse në Mbretërinë e Bashkuar ne kemi rritur vitet e fundit jashtëzakonisht bashkëpunimin, por nuk është shqëruar me të tillë fenomen", u shpreh Bazo. Njoftimi për dezertimin e 4 ushtarëve u bë publik nga Ministria e Mbrojtjes ditën e premte. Ushtarët komando janë nisur drejt Britanisë në 4 tetor 2017, të shoqëruar nga toger Roland Poçi. Në datën 19 tetor gjatë kthimit në atdhe, ushtarët Ylber Tokrri, Aleksandër Shkulaku, Klevis Lamkaj dhe Reni Ajazi nuk janë kthyer në Shqipëri, por kanë dezertuar, duke vendosur të emigrojnë në këtë vend. Gjatë intervistës gjenerali Jeronim Bazo u shpreh se ajo çka e trishton më së shumti është mënyra se si zgjedhjen të largoheshin nga Shqipëria katër ushtarët.

**Ka pasur një dezertim të 4 ushtarëve, si e keni parë këtë rast?**

Patjetër që e kam ndjekur rastin e fundit në fjalë, sepse, për hir të së vërtetës, dua të ndaj me ju ndjesinë që, sado të largohesh në kohë nga FA-të pas një shërbimi aq të gjatë, nuk të hiqet kurrë merak, vëmendja, shqetësimi. Ndjesia që unë përçolla ngjarjen e fundit ishte një ndjesi e tillë komplekse ku përzieh merak, në radhë të parë, për njerëzit trishtimi madje dhe pak inatosja, do të thosha.

**Inat pse?**

Sepse kemi arritur në një stad ku nuk është më e nevojshme për të gjetur të tilla mënyra hileqare, tinëzare për të bërë emigracionin në kurriz të taksapaguesve dhe, për më tepër, në kurriz të besimit që të është dhënë nën uniformën e nderuar të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. FA-të braktisjen e detyrës e shikojnë si një akt tradhtie dhe si një akt buracakërie. Kështu shikohet gjersisht në komunitetin e FA-ve në Shqipëri dhe jo vetëm.

**A nuk mund të shihet si**



Ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral Jeronim Bazo



Reni Ajazi



Aleksandër Shkulaku

**PAGA**  
Në qendër të vëmendjes është përmirësimi i kushteve të jetesës dhe motivimi më i mirë ekonomik-financiar, shoqëror e shpirtëror për FA-të. Është një proces i gjatë që nuk do të përfundojë kurrë. Në të gjitha vendet kërkohet që të kesh një motivim më të mirë, për të marrë më tepër pagë. Për hir të së vërtetës, paga që marrin sot, mesatarisht pjesëtarët e FA-ve është 350 mijë lekë të vjetra, ose diçka më shumë.

## "Pagesa mujore e komandove, 220 euro"

### Gazeta Britanike "The Sun": 4 ushtarët rrezikojnë 5 vite burg

**G**azeta Britanike "The Sun" i ka kushtuar një artikull lajmit për dezertimin e 4 komandove shqiptarë në Angli, duke sjellë detaje rreth trajnimit që ata po kryenin në Britani si dhe kushtet në të cilat punojnë ushtarakët në Shqipëri. "The Sun" shkruan se 4 komandot, të cilët u zhdukën në një mision trajnues në Britani, dyshohet se po fshihen, ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka nisur një hetim për ta, e me tej shkruan se për Reni Ajazi, Ylber Kotori, Aleksandër Shkulaku dhe Kleviz Lamkaj, mund të merret një masë dënimi me 5



Faksimile e gazetës britanike "The Sun"

vite burg. "Ata ishin në mesin e 11 shqiptarëve të trajnimit të NATO-s në Uellsin Qendror, fluturimet dhe akomodimi i të cilëve, përfshirë natën e fundit në Londër, u paguan nga Ministria e Mbrojtjes. Si

pas burimeve ata duhet të ishin kthyer në bazë dhe të ktheheshin për në Shqipëri ditën e nesërme. The Sun nënvizon edhe faktin se komandot merrnin një pagesë mujore prej 220 eurosh.

#### një akt i detyruar për të ndërmarrë këtë veprim? Sepse në bisedat e zhvilluara me të afërmit e tyre, baballarët e dy prej ushtarëve janë shprehur se rroga apo kushtet ekonomike i kanë detyruar të bëjnë këtë gjë.

Akti është i pajustificueshëm, i papranueshëm, i pa tolerueshëm. Nuk ka asnjë justifikim në botë që ti të braktisësh ekipin dhe skuadrën tënde. Supozojmë që kushtet janë të tilla, që të detyrojnë të ndërmarresh veprime të dëshpëruara në jetën e përditshme, por jo kur ti je futur për të shërbyer dhe kur je betuar për të shërbyer bashkë me shokët e tu. Këtë nuk ta falin shokët e tu në uniformë. Ti shkon së bashku në një mision dhe kthehesh së bashku dhe pastaj, nëse të ka ardhur litarë në fyt, ka mënyra të tjera për të dhënë dorëheqjen dhe për t'u larguar me nder nga FA-të, dhe të ndjekësh rrugët e

#### mundësitë më të mira për të rregulluar gjendjen ekonomike. Kjo nuk ka asnjë justifikim për të braktisur detyrën. Shkohet me ekipin, kthehesh me ekipin.

#### Përse kërkohet gjithnjë e më tepër të lihet ushtria?

Nuk do të thosha që është një fenomen masiv i lënies së ushtrisë.

#### Ama shprehje të madhe të dëshirës ka...

Duhet ta shikojmë nga të dyja anët, në hyrjet e reja dhe daljet. Pra, duhet parë i tërë procesi. Jam i sigurt që Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm tani që flasim me janë duke e analizuar me qetësi, me hollësi për t'i shkuar deri në fund fenomenit, për të rianalizuar dhe për të riparë të gjithë procedurën, që nga hyrja deri në dalje. Çfarë problemi ka, ku cedohet, ku janë vrimit, si mund të rregullohen çështjet ekonomike. Motivimi, incientivat që do t'u afrohen pjesëtarëve të FA-ve për të na shërbyer dhe

#### për të na përfaqësuar me nder si deri sot.

#### Çfarë motivimi kanë sot komandot?

Këtu bëhet fjalë për një stërvitje, që ka dhe formën e kompeticionit, që zhvillohet në Uellsin Qendror në Mbretërinë e Bashkuar dhe stërvitja quhet "Patrullimi në lartësi e Kambrias". Është një ushtrim dhe stërvitje e mirënjohur në të gjithë botën tashmë, që zhvillohet në Uellsin Qendror prej më se 50 vjetësh. Me kalimin e viteve ka filluar të jetë e hapur edhe për pjesëmarrës ndërkomandot. Pra, është një test, është një provë për të parë se sa mirë i zbaton në terren aftësitë e fituara gjatë stërvitjes në vendin të tyre. Për hir të së vërtetës ky ekip prej 11 vetash nuk gaboj, bashkë me komandantin e tyre dolën këtë radhë faqebardhë, ndërkohe katërshtja dështoi ose nuk u paraqit në pikën e grumbullimit për t'u kthy-

er në atdhe. Pra, mbasi kryen me sukses detyrën, vendosën të zhvishen nga uniforma dhe përgjegjësia që mban ajo dhe të kthehen në emigrantë të rëndomtë. Ky është problemi që unë nuk do t'ua falja.

#### A mbetet një vend joshës Britania e Madhe për këta ushtarakë, ndoshta edhe SHBA-të?

Do të thosha që ka qenë një periudhë kur vërtetë SHBA-të ishin një shënjestër joshëse dhe kemi pasur probleme nga fundi i viteve '90, fillim i viteve 2000, sidomos kur dërgonim ekupe të mëdha për t'u stërvitur së bashku me partnerët. Ka pasur cedime ose ndonjë dezertim ose mbetje. Kurse në Mbretërinë e Bashkuar ne kemi rritur vitet e fundit jashtëzakonisht bashkëpunimin, por nuk është shqëruar me të tillë fenomen.

#### Pra, ju gjatë detyrës suaj nuk keni hasur në një situatë të tillë?

Nuk e kam pasur për fat të mirë, por që nuk do të thosha sërish që është momenti për të baltosur punën, përgatitjen e FA-ve, pavarësisht nga kjo shuplakë e fortë.

#### Ju folët pak më parë për motivime, zoti Bazo, po paga a nuk është një motivim? A është parë kjo mundësi, për t'u rritur?

Patjetër që kjo është në qendër të vëmendjes, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe motivimi më i mirë ekonomik-financiar, shoqëror e shpirtëror për FA-të. Është një proces i gjatë që nuk do të përfundojë kurrë. Kjo gjë ndodh edhe në vendet partnere. Në të gjitha vendet kërkohet që të kesh një motivim më të mirë, për të marrë më tepër pagë. Për hir të së vërtetës, paga që marrin sot pjesëtarët e FA-ve është 350 mijë lekë të vjetra, ose diçka më shumë.

#### Kjo nuk është një pagë e mirë...

Kjo nuk është një pagë dinjitoze, nuk është aq mbështetëse, por këto janë kushtet e Shqipërisë sonë.

Në rang administrate publike, këto zënë një vend mesatar në atë çka paguhet administrata publike.

#### Po shteti sa paguan për trajnimin e një komandoje, për ta çuar me mision?

Këtu nuk ka shifra të sakta.

#### E kam fjalën a ka një buxhet të caktuar për trajnimin?

Po patjetër, për trajnimin, pjesëmarrje në stërvitje, pjesëmarrje në operacione. Ka një buxhet të posaçëm që afrohet për të mbuluar shpenzimet adekuatë për këtë çështje.

Ka shumë të përjashtuar në radhë të komandove. Vetëm vitin e kaluar, janë 25 komando të përfshirë në vepër penale, bëhet fjalë për grabitje, vrasje, trafik droge. A trajtohen nga ana psikologjike komandot, ushtarakët?

Kam përshpirtjen që shifra është e ekzagjeruar. Aq më shumë që edhe përkohërisht e veprave që shoqërojnë këto përjashtime në dënim paksa të tepruara.

#### Si bëhet përzgjedhja e ushtarakëve?

Ne gjithmonë e bëjmë me transparencë sipërore që kërkohet. I kemi ftuar gjithë mediat për të ndjekur procesin e rekrutimit. Bëhen 2-3 herë në vit. Rekrutohen 500-600 vajza e djem në vit.

#### Cilët janë elementet që shikoni?

Elementët janë diploma në radhë të parë e shkollës së mesme. Aftësitë fizike normale të konkurrenshme dhe pastërtia e figurës në kuptimin e rekordeve kriminale dhe këto i nënshtrohen një konkursi. Kalohet në një konkurs dhe në testim të hapur me komisione dhe me elementet të ruajtjes së besueshmërisë dhe sekretit. Një test intelektual dhe fizik. Ata që kualifikohen kalojnë në stërvitjen bazë, ditët e vështira në Bunavi të Vlorës. Pastaj fillon shërbimi në FA-të.

Skema e tjetërsimit të 36 hektarëve në Kavajë, përfitimet

# Skandali në Spille me pronat, ish-kreu i Hipotekës gati të japë detaje

## Seid Cikalleshi pendohet, pranon akuzat

Ish-kreu i Hipotekës së Kavajës Seid Cikalleshi ka pranuar akuzat dhe është gati që të bashkëpunojë me drejtësinë në lidhje me skandalin e tjetërsimit të pronave në bregdetin e Spillesë. Ai është vënë në dispozicion të prokurorisë për të shpjeguar mënyrën se si ka funksionuar transaksioni i pronave ranishte në zonën e plazhit. Nën akuzë për këtë ngjarje janë vënë edhe 10 zyrtarë dhe ish-zyrtarë të tjerë. Ndërkohë pritet që Seid Cikalleshi, vjeçri i kreu të PS-së në Kavajë, Gentian Dajës, të kërkojë gjykim të shkurtuar. Cikalleshi, së bashku me ish-nënprefektin e Tiranës, Fatos Kajën, janë ndër 11 personat e lënë në burg për tjetërsimin e 36 hektarëve të tokave në bregdetin e Spillesë. Cikalleshi u vetëdorëzua në polici, pasi u shpall në kërkim për skandalin e pronave, ku një pjesë e tyre ishin përvehtësuar edhe nga familjarë, të afërm të ish-kreut të Bashkisë së Kavajës, Elvis Rroshit. Burime thonë se ish-kreu u Hipotekës së Kavajës do të zbardhë skemën përpara hetuesve, se si u zhvillua tjetërsimi i hektarëve në Spille, sa kanë qenë përfitimet dhe cilët ishin aktorët kryesorë.

### SKEMA E TJETËRSIMIT

Seid Cikalleshi, në bashkëpunim me 10 të arrestuarit e tjerë, kanë falsifikuar dokumentet, duke bërë ndryshimin e zërit kadastral për një sipërfaqe prej 36 hektarësh tokë në vijën bregdetare Spille, Kavajë. Në parcelat me numër pasurie 1, 35, 37, 178, duke e tjetërsuar pronën nga tokë ranishte, në tokë arë, kanë bërë ndarjen në mënyrë të kundërligjshme të kësaj sipërfaqeje tokë në interes të



Ish-kreu i Hipotekës së Kavajës Seid Cikalleshi

tyre dhe personave të tjerë. Gjatë hetimeve paraprake, dokumentohet bashkëpunimi kriminal midis ish-

### DEKLARIMET

Nga deklaratimet e shtetasve që u janë shënuar emrat në Aktin e Marrjes së Tapisë së Pronës, rezultoi se nuk kanë pasur dijeni që janë pajisur me tokë e aq më tepër që nga viti 2000. Ata as nuk kanë bërë kërkesë dhe disa nuk janë pajisur me AMTP.

punonjësve të Komunës Kryevdh dhe punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë. Ata në bashkëpunim me njëri-tjetrin dyshohet se kanë krijuar në mënyrë fiktive komisione për ndarjen e tokës gjatë periudhës 2013-2016 dhe kanë realizuar tjetërsimin e ndarjen në mënyrë të jashtëligjshme të pasurisë shtetërore. Nga deklaratimet e shtetasve që u janë shënuar emrat në Aktin e Marrjes së Tapisë së Pronës, rezultoi se nuk kanë pasur dijeni që janë pajisur me tokë e aq më tepër që nga viti 2000. Ata as nuk kanë bërë kërkesë dhe disa nuk janë pajisur me AMTP, si dhe rastet e personave, të cilët kanë përfituar dhe tjetërsuar prona, pa ditur vendndodhjen e pronës apo

personat që e kanë tjetërsuar. Pra, rezultoi qartë se një numër i konsiderueshëm AMTP janë shfaqur një ditë të caktuar dhe janë bërë objekt regjistrimi. Pjesa më e madhe e tyre deklarojnë se i

### BASHKËPUNIMI

Gjatë hetimeve paraprake, dokumentohet bashkëpunimi kriminal midis ish-punonjësve të Komunës Kryevdh dhe punonjësve të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kavajë. Dyshohet se ata kanë krijuar në mënyrë fiktive komisione për ndarjen e tokës gjatë periudhës 2013-2016.

kanë dhënë shtetasit Ilir Kaja vetëm kartën e identitetit, pas vitit 2011, dhe më pas janë paraqitur te noterët për të bërë transaksione me persona që nuk i kishin takuar apo njohur më parë.

**Takimi tripalësh në Tiranë, Çako: Të parandalohet në çdo kohë terrorizmi**

Gjatë ditës së djeshme në Tiranë u mbajt takimi tripalësh mes drejtuesve të Strukturave Kundër Terrorizmit, mes policisë të Shqipërisë, Kosovës dhe policisë italiane. Në fokus të takimit ishte forcimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit në parandalimin dhe goditjen e çdo veprimtarie terroriste, që kërcënon vendet përkatëse. Drejtori i Policisë së Shtetit, Haki Çako, gjatë takimit shprehu gatishmërinë për një bashkëpunim sa më të shpejtë dhe efikas me vendet respektive. Ai vlerësoi punën e bërë dhe rezultatet e arritura në parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprimtarive terroriste në Shqipëri, Itali e Kosovë, e cila ka ardhur si rezultat i vullnetit që qeveritë respektive kanë për t'u përgjigjur sfida e mbështetur këto struktura ndaj çdo kërcënimi terrorist. Më pas palët diskutuan në nivel teknik për problematika të veçanta në ndjekje si dhe domosdoshmërinë për forcimin e bashkëpunimit në nivel operacional dhe shkëmbimi i informacionit për rastet kur ka të dhëna për veprimtari radikale/terroriste në të tri vendet.

## Diskutimi për transportimin e 200 mijë eurove

### "Financieri" i Habilajve, përgjimet e reja, bisedat në makinë

Gjykata për Krimet e Rënda zbardh vendimin që la në paraburgim Nezar Seitin, të dyshuarin si "financier" të grupit të Habilajve. Në vendimin e arsyetuar dalin në dritë përgjime të pa publikuara, pjesë e akteve të dosjes hetimore italiane kundër grupit kriminal të trafikut të drogës që dyshohet se drejtohej nga Moisi Habilaj. I tillë është përgjimi ambiantal i kryer në 2 shtator 2014 në mjedin e Moisi Habilajit. Mes tij dhe dy pasagjerëve Florian Habilaj e Nezar Seitit diskutohet për transportimin e një shumë prej 200 mijë eurosh, që do të fshiheshin në automjet. Duke iu referuar prerjes së kartëmonedhave, Nezar Seiti thotë që "nëse janë 100-she janë të mira". Florian Habilaj i thotë që janë 20-ëshe, ndërsa Nezar ia kthen "Nëse janë 20-she, na mori lumi". Dhjetë minuta më vonë, ata kërkojnë hapësira të fshehta në automjet. Dhjetë minuta më vonë, ata kërkojnë hapësira të fshehta në automjet. Nezar Seiti thotë: "Do i ngecim nga mbrapa sediljes dhe do ta mbyllim bram-bram", deklaroi "AbcNews". Në një



Gjykata për Krimet e Rënda

### PËRGJIMI

Duke iu referuar prerjes së kartëmonedhave, Nezar Seiti thotë që "Nëse janë 100-she, janë të mira". Florian Habilaj i thotë që janë 20-ëshe, ndërsa Nezar ia kthen "Nëse janë 20-she, na mori lumi". Dhjetë minuta më vonë, ata kërkojnë hapësira të fshehta në automjet.

tjetër përgjim të muajt shkurt 2017, Moisi Habilaj, Nezar Seiti dhe Maridian Sulaj kanë vënë në një pajisje të dyshimtë në mjedin e tyre. Mes psherëtimash dhe mallkimesh ata tentojnë ta

heqin, ndërsa dikush mendon se ajo është pjesë e tapicerisë. "Këtu nuk ka shanse. Vetëm të shkatërrojmë makinën, ta heqim tapicerinë e lart me, ta heqim dhe t'ia çojmë", shprehet Seita.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

**Subject:** Request for proposal "Curricula Development and Training Delivery on Self-employment and Business Planning"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive proposals from interested companies who wish to be considered for the above-mentioned service.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The proposal must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked UNDP/RFP/2017-42582 "Curricula Development and Training Delivery on Self-employment and Business Planning".

**For more details please refer to the link below:**  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=42582](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42582)

**Relevant dates:** All interested entities should provide their proposal, not later than **4 December 2017, 14:00 hrs.**, to the address:

United Nations Development Programme  
 "Skenderbej" Street, Gurten Center, 2nd Floor,  
 Tirana, Albania  
 UNDP Procurement team

ISSH publikon manualin, ja si do të përlogarit masa e pagesës, dokumentacioni i kërkuar

# Pensionet familjare, kategoritë që përfitojnë

## Si do të shpërblehen jetimet deri në moshën 25 vjeç

Voltiza Duro

Të gjithë personat që plotësojnë kushtet e paracaktuara në bazë të ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" iu lind e drejta e përfitimit të pensionit familjar. Disa ditë më parë Instituti i Sigurimeve Shoqërore, publikoi manualin ku përcaktohen në mënyrë të detajuar kategoritë përfituese të këtij pensioni e masën e përlogaritjes së tij. "Gazeta Shqiptare" publikon sot dokumentacionin e plotë që iu nevojitet për të marrë pension pleqërie. Nga ky i fundit, mund të përfitojnë të gjithë jetimet që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë. ISSH thekson se në momentin që i/e veja martohej sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar. Ndërsa në të gjitha ato raste kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50 % e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Gjithashtu, në manual përcaktohet edhe mosha kur përfitohet pensioni familjar nga i/e veja.

### KUSHTET

Pension familjar mund të përfitojë e veja mbi 55 vjeç, e paaftë për punë që është mbajtëse e një fëmije deri në 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit. Gjithashtu, nga kjo kategori pensioni përfiton edhe burri i ve mbi 60 vjeç e i paaftë për punë në rastet kur është mbajtës i një fëmije deri në 8 vjeç që ishte në ngarkim të të vdekurit. Të gjithë ata jetimë që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë mund të përfitojnë pension familjar. Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë. Në manualin e ISSH theksohet se: "Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të. Në këtë rast ata trajtohen si jetimë dhe përfitojnë pension familjar".



### KATEGORITË PËRFITUESE:

1. E veja që mban një fëmije deri në 8 vjeç; nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur 55 vjeç
2. Burri i ve, që mban një fëmije deri në 8 vjeç; nuk është i aftë të punojë, ka mbushur moshën 60 vjeç
3. Jetimet e moshës 18-25 vjeç që studiojnë apo janë të paaftë për punë
4. Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë
5. Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të

### JETIMET

Pension pleqërie mund të përfitojnë të gjithë jetimet që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë.

Por në momentin që i/e veja martohej sërisht, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

### MASA E PËRFITIMIT

Pensionin familjar konsiderohet ai pension që kishte apo i takonte të ndjerit. Personi i ve, merr 50 % të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, kur është i vetëm dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25 %, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100 për qind, masën e

tij. Ndërsa në të gjitha ato raste kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50 % e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. "Kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues janë dy ose më shumë persona, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 %, por jo më shumë se 50 % e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri". - citohet në manual. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindërit që jetonin në punë, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 % e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 % e tij. Ndërsa jetimi, i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre.

Në kohën që përfundon afati i pagesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkangjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

### DOKUMENTACIONI

Të gjithë ata individë që do të aplikojnë për të fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar, përveç kërkesës, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin. Respektivisht ata duhet të paraqesin certifikatën e gjendjes familjare, fotokopjen e letrës së njoftimit elektronik për kërkesin, ose përfituesit e tjerë si dhe certifikatën e vdekjes së të ndjerit në të cilën duhet të jetë shënuar edhe shkaku i vdekjes. Gjithashtu, aplikuesi për pension familjar duhet të dorëzojë edhe dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës si librezja e punës apo vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj. Bashkangjitur dokumentacionit të mësipërm, duhet të dorëzohen edhe dokumentet që vërtetojnë të qenit në ngarkim të të ndjerit si: vërtetimi i vazhdimit të shkollës për jetimet që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, vërtetimi që në ngarkim të të vdekurit ishte një i ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, vërtetimi për personin e ve, që është kërkuar për punë, vendimi i KMCAP-it për paafësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune etj. Nënvojzimet se në kërkesën për pension familjar, jetimi që ka moshën ligjore për t'u punësuar, kur nuk vazhdon shkollën duhet të paraqesë vër-

### DOKUMENTACIONI

Dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin:

- Certifikatë e gjendjes familjare;
- Certifikatë vdekjeje e të ndjerit/të ndjerës;
- Fotokopje e Kartës së identitetit për kërkuuesin, ose përfituesit e tjerë.

Dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës:

- Librezja e punës;
  - Vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj;
  - Vendimi i emërimit në punë, si kuadër në ish-kooperativat bujqësore;
  - Vendim gjykatë për njohje të vjetërsisë në punë;
  - Vërtetimi i Degës Ushtarake për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për kërkuuesit meshkuj);
  - Vërtetimi i vjetërsisë në punë për ushtarakët.
- Dokumentet që vërtetojnë të qenit në ngarkim të të ndjerit/ndjerës: - Vërtetimi i vazhdimit të shkollës për jetimet që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar;
- Vendimi i KMCAP-it për paafësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune;
  - Vërtetimi i organeve të pushtetit lokal që në ngarkim të të vdekurit ishte një i/e ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, i cili ishte në ngarkim të të vdekurit;
  - Vërtetimi për personin e ve, që është kërkuar për punë;
  - Proces-verbal, që provon faktin e vdekjes nga aksidenti në punë, si dhe vendimi i KMCAP, kur vdekja është shkaktuar nga sëmundje profesionale;
  - Vërtetimi i organeve të pushtetit lokal që prindërit, prindërit e prindërve nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë dhe jetonin në të njëjtën familje me atë që ka vdekur, jo më pak se një vit para vdekjes;
  - Vërtetimi nga organet e prokurorisë ose gjykatës për rastet kur kërkohet të përfitohet nga Dekreti nr. 758, datë 01.04.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut";
  - Vërtetimi nga ministria përkatëse për humbjen e jetës së pilotit në përmbytje të detyrës gjatë fluturimit;
  - Vërtetimi që nuk është i punësuar apo vetëpunësuar, për jetimin që ka moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, kur nuk vazhdon shkollën dhe është nën 18 vjeç (kur banon në qytet) dhe nën 16 vjeç (kur banon në fshat).
- Dokumentet që vërtetojnë të ardhurat e realizuara:
- Vërtetimi page, sipas së cilës është derdhur kontribut për periudhat e sigurimit që nga 01.01.1994 deri në momentin e shkëputjes nga puna, sipas formularit tip;
  - Vërtetimi i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës.

tetimi nga Zyra e Punës. Edhe vërtetimi i pagës duhet të përshihet në dosjen e dokumenteve si dhe vërtetimi i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës. Ndërsa të gjithë ata persona që përfitojnë nga ligji "Për pajësinë, amnistinë dhe reha-

bitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" duhet të dorëzojnë vërtetimin e gjendjes gjyqësore mbi kohën e vuajtjes së dënimit, çdo dokument tjetër që vërteton të qenit në punë dhe vërtetimi mbi faktin e dënimit për motive poli-



"Misteri", 52-vjeçari u denonca i zhdukur nga gruaja në Itali dhe i vëllai në Durrës

# Gjendet një kufomë në brigjet e Leçes, dyshohet të jetë e avokatit Besnik Muço

## Prokuroria e Maceratas: Pritet analiza e AND-së

ITALI

Një trup i pajetë, i gjetur para afro dy javësh pranë një shkëmbi në brigjet e Leçes në Itali dyshohet se i përket avokatit shqiptar Besnik Muço, i cili rezultoi i zhdukur që më 2 nëntor të këtij viti, teksa udhëtonte me traget nga Shqipëria drejt vendit fqinj. Sipas mediave italiane trupi i pajetë, i gjetur më 6 nëntor, kishte disa ditë në det. Pas dyshimeve të ngritura nga autoritetet e këtij vendi, prokuroria e Maceratas ka kërkuar të bëhet analiza e ADN-së, për të verifikuar nëse bëhet fjalë për avokatit shqiptar Muço me nënshpëtimet italiane. Dyshimi bëhet më i fortë, pasi mediat italiane bëjnë me dije se në zonën ku u gjet kufoma, nuk është zhdukur ndonjë person tjetër. Për 15 vjet, avokati ka jetuar në Macerata, aty ku ndodhen aktualisht bashkëshortja dhe dy fëmijët. Ka qenë gruaja e 52-vjeçarit, ajo që ka denoncuar zhdukjen e të shoqit të karabinierët e Maceratas. Pas denoncimit, prokurori e Durrësit ka nisur hetimet për veprën penale "Rrëmbim personi". Ajo që dihet deri tani, është fakti se më 2 nëntor Besnik Muço u nis nga Durrësi në drejtim të Barit me tragetin e linjës Adria Ferries. Ai ka hipur në traget, por pas orës 23:00 celulari i tij ishte i fikur. Që nga ai moment askush nuk ka arritur të kontaktojë me të. Nga ajo që është zbuluar më pas, gruaja e tij Raimonda që jeton në Macerata nuk e dinte që burri i saj do të kthehej atë ditë dhe as e imagjinonte se kishte marrë tragetin, pasi zakonisht udhëtonte me avion.

### HETIMET NË SHQIPËRI

Për zhdukjen e avokatit Besnik Muço janë bërë dy denoncime, një nga bashkëshortja e tij Raimonda në



Avokati i zhdukur Besnik Muço

### SENDET PERSONALE

Me datë 3 nëntor, punonjësit e tragetit "Adria", gjetën sendet personale të avokatit (një xhup dhe një çantë krahu). Nga këqyrja e xhupit dhe çantës, në zyrën e kapitenit të tragetit është konstatuar një kartë identiteti italiane në emër të Besnik Muços; një biletë e datës 2 nëntor, ora 20:11; kartë shëndeti italiane dhe një kartë kodifikuska po në emër të tij. Ndërsa, mungonte pasaporta shqiptare e avokatit, me shtetësi italiane dhe kombësi shqiptare.

Itali dhe nga i vëllai, Viktor Muço në Durrës. Për rastin në fjalë, 5 ditë më parë, edhe prokuroria e qytetit bregdetar nisi hetimet për rrëmbim personi. Në referimin e veprës penale në prokurori, OPGJ shkruan se është vënë në dijeni për largimin nga banesa të shtetasit Besnik Muço më datë 10 nëntor, ditën kur ka bërë kallëzim vëllai i avokatit, Viktor Muço. Ndërkaq,

punonjësit e tragetit "Adria", me të cilin udhëtonte avokati kanë shpjeguar se më datë 3 nëntor, kur trageti ishte ankoruar në Bari të Italisë, në sallë kanë gjetur një xhup dhe një çantë krahu. Nga këqyrja e çantës janë konstatuar dokumente në emër të shtetasit Besnik Muço, me shtetësi italiane dhe kombësi shqiptare. OPGJ së bashku me specialistin e Policisë Sh-

**AVOKATI**  
Besnik Muço më parë ka punuar në organet e drejtësisë dhe deri në vitin 1997 ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjatë trazirave të marsit 1997, ai bashkë me gruan dhe djalin u larguan në Itali, duke u vendosur në provincën e Maceratas, 50 km larg Ankonas. Deri para 4 viteve avokati ka qenë në Itali, por më pas u kthye në Shqipëri, sepse humbi punën. Ai u kthye i vetëm, ndërsa gruaja me dy fëmijët qëndruan në Itali.

**LETËR POROSIA**  
Policia e Durrësit është duke pritur një letër porosi nga autoritetet e prokurorisë italiane, ndërkohë që në vijim të hetimeve është kërkesa e policisë të kompania telefonike celulare. "Do të kërkojmë tabulatet për të parë me kë ka folur për herë të fundit Besnik Muço, çfarë ka thënë dhe kush ka qenë personi, me të cilin ka folur", -thënë burimet policore.

kencore kanë shkuar në tragetin e mësipërm ku është këqyruar salla në katin e tetë të tragetit ku janë gjendur xhupi dhe çanta e shtetasi Besnik Muço. Nga këqyrja e xhupit dhe çantës, në zyrën e kapitenit të tragetit është konstatuar një kartë identiteti italiane në emër të shtetasit Besnik Muço; karta kodifikuska në emër të shtetasit Besnik Muço etj. Ndërsa, mungonte pasaporta shqiptare e avokatit. Besnik Muço më parë ka punuar në organet e drejtësisë dhe deri në vitin 1997 ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Gjatë

trazirave të marsit 1997, ai bashkë me gruan dhe djalin u larguan në Itali duke u vendosur në provincën e Maceratas, 50 km larg Ankonas. Deri para 4 viteve avokati ka qenë në Itali, por më pas u kthye në Shqipëri sepse humbi punën (u mbyll ndërmarja ku punonte). Ai u kthye i vetëm, ndërsa gruaja me dy fëmijët qëndruan në Itali. Muço jetonte prej një viti me qira dhe ushtronte aktivitetin e tij si avokat përballë prokurorisë së Tiranës, bashkë me një person tjetër. Për të ndarë më shumë kohë me familjen, ai udhëtonte të paktën dy herë në muaj nga Durrësi në Bari për të shkuar në Macerata, aty ku edhe jeton familja e tij.

### SHKURT

**Burri e masakroi me thikë, i jepet lamtumira e fundit 30-vjeçares Kellezi ELBASAN** - Dy javë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Udine të Italisë, Migena Kellezi, e cila u masakrua me thikë nga i shoqi është përcjellë dje për në banesën e fundit në Elbasan. Mësohet se miq, familjarë e të afërëm morën pjesë në ceremoninë mortore, ku i dhanë lamtumirën 30-vjeçares. Krimi ndodhi më 8 nëntor në banesën e çiftit shqiptar në Gradisca d'Isonzo. Sipas autoriteteve italiane, Dritan Sulollari e vrau bashkëshorten pas një shërri për motive hoxhozie. Pas krimit, Sulollari, telefoni policinë, por, kur u mor në pyetje deklaroi se nuk mbante mend asgjë. Nga hetimet e kryera, rezultoi se çifti ishte në proces divorci, ndërsa paraprakisht kishte rënë dakord që djali 8-vjeçar të jetonte me nënën.

**Zhdukët 13-vjeçarja: Familjarët: Nuk u kthye nga shkolla**

**KRUJË** - Një familje në qytetin e Krujës po kalon momente të vështira, pasi vajza e tyre vetëm 13-vjeçe rezultoi të zhdukur që prej të premtës. Denoncimin në polici e ka bërë motra e vajzës së mitur D.P. Sipas rrëfimit të 24-vjeçares në ambientet e policisë, motra e saj 13-vjeçare është nisur si çdo ditë në shkollë, por dy ditë më parë, pas mbarimit të mësimit nuk është kthyer në shtëpi. Ndërsa familja nuk ka dijeni për vendndodhjen, policia e Krujës është vënë në lëvizje për gjetjen e së miturës.

**Po rregullonte prizën e televizorit, humb jetën 68-vjeçari**

**KLAN** - Një 68-vjeçar nga Pogradeci ka humbur jetën ditën e djeshme, pasi ka rënë në kontakt me rrymën elektrike. Bëhet fjalë për shtetasin A.M. nga fshati Zagorçan i këtij rrethi. Burime nga policia lokale bënë me dije se 68-vjeçari ka qenë duke punuar me prizën e televizorit, kur ka rënë në kontakt me energjinë. Menjëherë i moshuari është dërguar në spital, por pavarësisht ndihmës së dhënë nga mjekët, ai ndërroi jetë. Pas sinjalizimit për vdekjen e çiftit shtetasi, u ngrit grupi hetimor, i cili po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

## Vetëm 1 në spital, vihet në punë kaldaja e shkollës Asfiksimi i 68 nxënësve e mësuesve në gjimnazin e Shupenzës në Bulqizë, prokuroria nis hetimet

**BULQIZË** - Asfiksimi masiv në shkollën e mesme "Rifat Manjani" në Shupenzë të Bulqizës ka bërë që prokuroria e Dibrës të nisë hetimet për zbardhjen e kësaj ngjarjeje. Dy ditë më parë, burime policore pohuan për "GSH" se 66 nxënës dhe 2 mësues përfunduan në spital për shkak të afiksimit nga bllokimi i tubave të kaldajës së shkollës. Sipas bluve, ngjarja ndodhi rreth orës 10:40 të së premtës. Përhapja e tymit dhe dyksidit të karbonit nëpër klasa bëri që nxënësit të transportoheshin me urgjencë në

spitalin e Bulqizës dhe të Peshkopisë. Ndërsa, u transportuan me helikopter në QSUT nxënësja 16-vjeçare me iniciale A.M. dhe mësuesi 43-vjeçar Petrit Alimani. Mësohet se prokuroria ka sekuestruar dokumentet lidhur me punimet e kryera për instalimin e kaldajës për të kryer verifikimet sa i takon cilësisë së punimeve. Gjatë marrjes në pyetje, punonjësit të shkollës në fjalë kanë deklaruar se kur është ndezur kaldaja të premtën ka funksionuar normalisht. Por më pas ka rezultuar se oxhakët kanë qenë të bllokuar. E ndërsa po vi-

jojnë hetimet, gjendja e nxënësve të gjimnazit të Shupenzës është përmirësuar. Burimet e mësipërme deklaruan dje se vetëm një nxënës ndodhet i shtruar në spitalin e Bulqizës dhe se të tjerët janë kthyer në banesat e tyre. Ndërkaq, ditën e djeshme bashkia e Bulqizës ka bërë testin e radhës për sistemin e ngrohjes, ashtu siç urdhëroi dy ditë më parë ministria e Arsimit Lindita Nikolla, sipas së cilës mësimi atje do të ndërpritej derisa të rritet temperatura. Nga testi i realizuar në shkollën e Shupenzës ka rezultuar se tashmë çdo gjë është në



Nxënësit e Shupenzës në spital

rregull. Nga ana tjetër, deputeti i zonës, Përrparim Spahiu njoftoi se të hënën procesi mësimor mund të vijojë normalisht. "Dje (të premtën) u krijua panik i madh me përdorimin e

fjalës gaz. Ishte situatë stressi dhe tensioni, që erdhi nga bllokimi i oxhakut. Ngrohja bëhet me pelele, një substancë shumë ekonomike dhe mjaft miqësore me mjedisin", tha ai. **en. do**

Operacioni "Balerina" në qytetin e Shkodrës, sekuestrohen hoteli dhe dy automjete të kokës së bandës

# Goditet grupi i prostitucionit, 7 në pranga

*Policia: Organizator i veprimtarisë kriminale, 50-vjeçari Rinard Tota*

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një tjetër grup i strukturuar kriminal është goditur në kuadër të operacionit "Forca e ligjit". Pak ditë pas operacionit të ndërmarrë në Fier ku u prangosën tre persona për vrasje dhe drogë, "Forca e ligjit" ka mësyrë në Shkodër: Policia e qytetit verior në bashkëpunim me Forcat e Drejtorisë Operacionale dhe prokurorinë e këtij rrethi kanë arrestuar 7 persona, të cilët akuzohen për shfrytëzim prostitucioni. Mësohet se aktiviteti kriminal ushtrohej në një hotel të njohur në Shkodër. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Balerina", në lagjen "Xhabie" në Shkodër është sekuestruar ambienti 3-katësh (hotel dhe lokal) në pronësi të 50-vjeçarit Rinard (Frederik) Tota ku ushtrohej aktiviteti kriminal.



I arrestuari Rinard (Frederik) Tota



Momenti i arrestimit nga policia

## OPERACIONI

Pas një hetimi disa mujor me metoda speciale, blutë e Shkodrës kanë vënë në pranga 7 persona të dyshuar si anëtarë të grupit kriminal "Balerina". Konkretisht janë arrestuar shtetasit: Rinard (Frederik) Tota, 50 vjeç, banues në Shkodër; i dënuar disa herë për vepra të ndryshme penale; Kastri-

ot Musa, 41 vjeç, banues në fshatin Barbullush Shkodër; S.M., 32 vjeç, banuese në qytetin e Shkodrës, e dënuar më parë për veprën penale ushtrim prostitucioni; A.M., 33 vjeç, banuese në Shkodër; A.L.L., 33 vjeç banuese në Lezhë dhe A.M., 33 vjeç, banuese në Shkodër. Nderkaq, është pro-

ceduar në gjendje të lirë shtetasi K.N., banues në qytetin e Shkodrës. Sipas burimeve policore, dyshohet që Rinard Tota ishte organizator i kësaj veprimtarie kriminale ku prej kohësh shfrytëzonte për ushtrim prostitucioni shtetaset e sipërpërmendura, në lokal në tij "TATA", në qytetin e Shkodrës. Sakaq, në cilësinë

## PERSONAT E ARRESTUAR

1.Rinard Tota	50 vjeç, Shkodër
2.Kastriot Musa	41 vjeç, Shkodër
3.S.M.	32 vjeç, Shkodër
4.A.M.	33 vjeç, Shkodër
5.A.L.I.	33 vjeç Burrel
6.A.N.	25 vjeç, Lezhë
7.A.M.	33 vjeç, Shkodër

e provave materiale janë sekuestruar: Ambienti tre katesh në pronësi të shtetasit Rinard (Frederik) Tota, në të cilin realizohej veprimtaria kriminale; dy automjete tip "Benz" dhe "Land-Rover" në pronësi të Totës; një pistoletë; shtatë ora dore; një sasi e konsiderueshme bizhuterish floriri të ndryshme; një laptop dhe 8 telefona celularë të markave të ndryshme si dhe një sasi parash të fituara nga ky aktivitet kriminal në prerje të ndryshme lekë,

euro, dollarë etj. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për veprat penale: "Prostitucioni", "Shfrytëzim prostitucioni", "Mbajtje e ambienteve për prostitucion" dhe "Pastrim produkte të veprës penale". Policia e Shtetit po vijon punën intensive në kuadër të operacionit "Forca e ligjit" për realizimin e plotë të objektivit për shkatërrimin e të gjitha grupeve të skeduar kriminale dhe sekuestrimin e aseteve të tyre financiare.

# BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



DPSHTRR: Detyrimet që fshihen, si të kryeni verifikimin nga targat

FSHIRJA E DETYRIMEVE

Subjektet që duan të mbajnë mjetin në qarkullim u fshihen detyrimet tatimore për periudhat dhjetor 2010 e më parë, me kusht që të paguajnë detyrimet për periudhën janar 2011 e në vijim, me përjashtim të gjgabave për mospagesë së taksave të periudhës janar 2011 deri në dhjetor 2014, të cilat fshihen/shuhën me kushtin e pagesës së të gjitha detyrimeve të plota", thuhet në njoftim DPSHTRR.

Ornela Manjani

Drejtorja e Shërbimit të Transportit Rrugor ju kujton drejtuesve të mjeteve që kanë detyrime të pashlyera se kanë afat deri në 31 dhjetor për të përfituar nga amnistia. Zbatimi i ligjit "Për pagesën dhe fshirjen/ shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore", ka hyrë në një fazë të rëndësishme. Kështu thotë në një njoftim të fundit, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, ku thekson se procedurat mund të...

Amnistia për makinat, afati deri në 31 dhjetor Janë 140 mijë automjete që përftojnë nga falja

ndiqen deri më datë 31 dhjetor 2017. "Brenda datës 31.12.2017, njoftohen të gjithë qytetarët që të përfitojnë nga procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/...

shuarjes së detyrimeve. Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka publikuar dhe azhurnuar listën e mjeteve objekt i ligjit 33/2017, ku të gjithë personat e interesuar...

mund të bëjnë verifikimin e targës dhe karakteristikave të tjera të mjetit në këtë listë. Subjektet e personat përgjegjës të paraqiten pranë Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transpor-

tit Rrugor për të kryer pa pagesë, veprimet e heqjes nga qarkullimi të mjetit apo për të kërkuar moskryerjen e procedurës së heqjes nga qarkullimi dhe mbajtjen aktiv të tij.

TARGAT E MJETEVE QË KANË DETYRIMET TË PASHLYERA

Table with multiple columns of license plate numbers (TARGA) and corresponding identification codes for vehicles with unpaid taxes.

## PANAIRI

Fatmira Nikolli

## Betim Muço

## Çmimi i panairit për librin që pat në duar para vdekjes

Betim Muço, poet e shkencëtar u nda nga jeta në moshën 68-vjeçare në janar të 2015-ës. Ai u shpall dje autor i vitit me veprën "Yjet janë fare pranë", për trajtimin në thellësi dhe elegancë stilistike e gjuhësore të temës së emigracionit në kontekstin kombëtar. Çmimin në nder të autorit, i cili u nda nga jeta dy vite më parë, e tërhoqi motra e tij. "Ky roman me të cilin nderohet me çmim është shkruar në muajt e fundit të jetës. Është i përfunduar kapitulli i fundit, dhe nën kujdesin e Martës ai ka parë dritën e botimit", tha Tefta Muço.

Timid dhe i tërhequr, siç ish, shkoi në heshtje, siç edhe jetoi. Autori i disa vëllimeve poetike, tregimeve të shkurtra, novelave dhe romaneve, para se të shuhej ai kish në duar një tjetër veprë: "Yjet janë fare pranë", me autor Betim Muço, krijimi artistik i fundit i tij, të cilin e la në dorëshkrim e të përfunduar, është botuar nën siglën e "OMSCA-1". E shoqja, Marta, pat thënë se libri që po merrni në duar u shkrua në gjysmën e dytë të vitit 2014 dhe deri në 14 janar 2015. Betim Muço kishte kohë që përtypte lëndën e parë të narracionit në mendjen e tij. Ishte një përasiatje e gjatë që fillonte nga historitë e mbledhura me dashuri nga burimi i pashershem i gjyshes së tij dhe rrënjët në Permetin e largët, ëndrrat e tij për astronominë dhe yjet e deri te vëzhgimet e udhëtimit e pafundme profesionale që ai kishte pasur gjatë dhjetë viteve të para të tranzicionit shqiptar nëpër Europë e më tej.

"Unë pata fatin të vesh-troja nga afër procesin e vështirë dhe sublim të krijimit të këtij libri që, për fat të keq, autori nuk arriti të vinte pikën e fundit me dorën e tij", shprehej bashkëshortja Marta Muço. Ajo çka e bën këtë libër veçanërisht të dashur për të është fakti se Betimi punoi në të deri në momentin e fundit të jetës së tij, deri vetëm pak orë përpara se të ndahej nga jeta, dhe Marta kish përsh-typpjen se aty midis rrethave është fryma e tij e fundit, mendimi i tij i fundit.

## ÇMIMET

Një ditë para mbylljes së Panairit të Librit të vitit 2017, juria e përbërë nga emra të njohur të letrave shqipe vlerësoi autoritë e përkthyesit më të mirë të edicionit të 20.

Diana Çuli u vlerësua si përkthyesja më e mirë e vitit për sjelljen në shqip të autorit arbëresh Carmine



Abate. Shkrimtarja tha se "Sigurisht çdo vlerësim për punën tonë është një kënaqësi shumë e madhe. Kishte konkurrentë të fortë, njohës të gjuhës e përkthim-it, kështu që ndihem e vlerësuar që në atë grup të ndriçuar u vlerësova", tha Diana Çuli, përkthyesja.

Nga ana tjetër, botimi "Faik Konica dhe dritëhijet e një diplomati", me autor Agron Alibalin, u vlerësua

## Vlerësohen Diana Çuli, Persida Asllani, Agron Alibali dhe disa botues

në kategorinë e letërsisë studimore origjinale. Autori tha dje se ndihej i lumtur, i emocionuar dhe i detyruar për diçka tjetër në të ardhmen.

Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare Persida Asllani, "rikthehet" të libri dhe në

përppjekjen e saj për të sjellë një libër për fëmijë duke edukuar përmes letrave, ajo vlerësohet me çmim. Asllani u çmua dje për botimin "Më quajnë Musine Kokalari", pjesë e një serie për të vegjëlit që synon njohjen e tyre me figura historike. "Është



një emocion i veçantë. Kisha dyshimet e mia, a është në formën e duhur, në ligjërimin e duhur për fëmijët. Fakti që juria e vlerësoi nga ky këndvështrim, ndoshta nuk do t'i mërzisë fëmijët me këtë libër", tha Persida Asllani, shkrimtare.

Meqenëse ishte dhe përvojatori i 20-të i saj, Shoqata e Botuesve mendoi të nderojë dhe botuesit e librarët, për ç'arsye, me çmime në këtë edicion të veçantë u vlerësua për herë të parë edhe Shtëpia Botuese "Onufri", për seriozitetin dhe pasionin këmbëngulës për 25 vite punë botuese, në shërbim të lex-

uesve, duke botuar me qindra tituj, autorë e vepra të rëndësishme të kulturës shqiptare e botërore, ku shquan veçanërisht vepra e Mjeshtrit të madh Ismail Kadare.

Shtëpia Botuese "Pika pa sipërfaqe" u vlerësua për kujdesin dhe vëmendjen e dalluar për botimin e veprave me shumë vlera në fushën e letërsisë, kritikës, filozofisë a historisë.

Libraria "Adrion" u çmua si shembulli më i mirë i punës profesionale plot përkushtim ndaj librit në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaja, si një përvojë model në punën për tregtimin e librit dhe marrëdhëniet me lexuesit. Ndërsa, Libraria "Artin", Prishtinë-Tiranë, e zotit Jahir Ahmeti u çmua si urë shembullore e kulturës dhe e librit në gjuhën shqipe, midis Shqipërisë e Kosovës, një mbështetje për lexuesit e të gjitha moshave, veçanërisht të rinjë dhe studiuesve. Një vlerësim i veçantë shkoi edhe për Librarinë Universitare në Shkodër dhe për Arian Gogën, për kujdesin dhe dashurinë në punën me librin në qytetin e Shkodrës, duke përcjellë me dinamikë botimet më të mira bashkëkohore, për t'i shërbyer lexuesit.

## Shoqëria e lëngshme e Umberto Ecos, në shqip "Pape Satan aleppe"

Një koleksion esesh rreth botës moderne nga njëri prej figurave letrare më të mëdha dhe autor best-seller në botë.


"Papa Satan aleppe" i Umberto Ecos, përkthyer nga Agim Dokani e Mariana Ymeri nën siglën e Diturisë, vjen në panair për të sjellë një këndvështrim mbi krizën e ideologjive, krizën e partive e individualizmin i shfrenuar. Ky është mjedisi, mjaft i njohur, ku lëviz: një shoqëri e lëngshme, ku jo gjithnjë është e lehtë të gjeësh një yll polar (edhe pse fare lehtë mund të gjeësh një

dhe yllka).

Gjejmë këtu fytyrat më të njohura të kësaj shoqërie: maskat e politikës, obsesionet mediatike për të rënë në sy që të gjithë (ose thuajse) duket se e bashkëndajmë, jetën simbiotike me telefonat tanë.

"Nuk ka më marrëdhënie ballë për ballë, njeriu nuk shikon më peizazhin, nuk reflekton mbi jetën dhe vdekjen, por i lëshon fjalët breshëri, thuajse gjithnjë pa asgjë të ngutshme për të thënë".

Është një shoqëri, shoqëria e lëngshme, ku non sensi duket se del mbi racionalitetin, me efekte



sigurisht komike të papërsëritshme, por me pasojë jo përnjëmend premtuese. Pëshqjellim, mungesë koherence, rrebesh fjalësh, shpesh në caqet e frazave shabllone.

"Pape Satàn, pape Satàn aleppe", thoshte Dante në Ferri (VII,1), mes çmerisë, dhimbjes, mllëfit, kanosjes dhe ndoshta ironisë.

Umberto Eco është një zë ndërkombëtar për kulturën. Në këtë antologji të tij të fundit, eseisti dhe roman-

cieri i famshëm, e vëzhgon botën që ndryshon me kureshtje të papërmbytur dhe me mençuri të thellë. Ashtu si disa studiues të tjerë para tij, Eco tregoi se një erudit me përmasat e tij, ishte i zoti shkruante për shumë lloje lexuesish. Kronika të një shoqërie të lëngshme përmban më shumë se 100 artikuj editoriale, të ndarë në 15 pjesë me tituj shumë tërheqës. Ecoja nuk ishte kritizues, por ai nuk e duronte dot, f.v., "teprimin e budallallëkut, që po bllokoi linjat e internetit". Ky libër është një duratë për lexuesin e tij: izgjuar, i mprehtë dhe ndriçues.

E DIEL  
19 Nëntor  
2017

MILOSA O



ZBULIMI

# Kush ishte i pari protestant shqiptar?

NGA DR. DAVID HOSAFLOOK

Përvjetori i 500-të i Reformacionit Protestant po kremtohet në të gjithë botën, përfshirë edhe në trevat shqiptare. Në Republikën e Maqedonisë muajin e kaluar u zhvillua një konferencë shkencore mbarëballkanike për Reformacionin, nën kujdesin e kryetarit të parlamentit, z. Talat Xhaferi. Në Kosovë u zhvilluan disa evenimente me mbështetje të qeverisë së Kosovës, si: një akademi solemne, një simpozium shkencor dhe emetimi i një pulle postare me tematikë Reformacionin. Kurse në Shqipëri, përveç evenimenteve të realizuara nga Vëllazëria Ungjillore, Biblioteka Kombëtare dhe Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante çelën së bashku një ekspozitë me Bibla në shqip, ashtu siç bëri Mit'hat Frashëri 90 vjet më përpara, në vitin 1927.

Lëvizja Protestante ndër shqiptarë ka një histori 200-vjeçare, duke zënë fill në kohën kur misionari skocez Robert Pinkertoni filloi të interesohej për përkthimin e Dhiatës së Re për herë të parë në shqip, në vitin 1816, përpjekje që u kurorëzua më 1827 me botimin e përkthimit të Vangjel Meksit. Para 125 vitesh, Gjerasim Qiriazi, i pari predikues protestant shqiptar, themeloi Vëllazërinë Ungjillore, e cila, sipas statutit të saj, kishte si qëllim "të përhapurit" e

Ungjillit edhe të shkronjave shqipe në Shqipëri". Për një kohë të gjatë është menduar se Gjerasimi ishte i pari protestant shqiptar (përveç disa tezave të ndryshme të pavërtetuara me dokumente për disa të tjerë). Mirëpo, kohët e fundit, kemi zbuluar një dokument befasues, i cili pohon se Konstandin Kristoforidhi qenka konvertuar në besimin protestant në vitin 1857. Lidhja e Kristoforidhit me protestantët nuk është diçka e re, meqë ai ka punuar me Shoqërinë Bib-

like Britanike dhe për Vendet e Huaja për përkthimin e teksteve biblike, në të dyja dialektet e shqipes. Prej vitesh, studiuesit shqiptarë kanë përfitur nga dhjetëra libra dhe artikuj të prof.dr. Xhevat Lloshi për këtë temë. Por deri tani nuk kishim asnjë provë që vërtetonte që Kristoforidhi kishte përqafuar besimin protestant si besimin e vet. Tani e kemi. Njoftimin e kemi nga misionarët amerikanë Daniel Ladd dhe Edëard Dodd, të cilët punonin në

kishën protestante në Smirnë, ku ndodhej edhe Kristoforidhi. Misionarët dërgonin raporte të rregullta, për të treguar mbarëvajtjen e veprimtarisë së tyre. Raportin në fjalë e zbulova gjatë hulumtimeve për disertacionin tim me titull "Lëvizja Protestante ndër shqiptarët, 1816-1908". Është raportin i tretë vjetor i Shoqërisë në Ndihmë të Misioneve në Turqi, për vitin 1856-1857. Me anë të këtij dokumenti, zbulojmë se Kristoforidhi u anëtarësua në një kishë protestante disa vite para se të lidhej me Aleksandër Tomsonin dhe me Shoqërinë Biblike. Ndonëse e shfrytëzova për disertacionin, sot, ky fakt po botohet për herë të parë për publikun e gjerë. Gjithashtu, meqë ky zbulim na vjen në kohën e 500-vjetorit të veprimtarisë së reformatorit gjerman Martin Luther, është e udhës të ribotohet këtu edhe një artikull nga "Gazeta e re", botuar më 28 dhjetor 1928, i cili e krahasonte K. Kristoforidhin me M. Lutherin dhe e quante Kristoforidhin "reformatorit shqiptar".



Vijon në faqen 14

D

DOKUMENT

Për një kohë të gjatë është menduar se Gjerasimi ishte i pari protestant shqiptar (përveç disa tezave të ndryshme të pavërtetuara me dokumente për disa të tjerë). Mirëpo, kohët e fundit, kemi zbuluar një dokument befasues, i cili pohon se Konstandin Kristoforidhi qenka konvertuar në besimin protestant në vitin 1857. Lidhja e Kristoforidhit me protestantët nuk është diçka e re, meqë ai ka punuar me Shoqërinë Biblike Britanike dhe për vendet e huaja për përkthimin e teksteve biblike, në të dyja dialektet e shqipes....

Zbulimi/Kush ishte i pari protestant shqiptar?

NGA DR. DAVID HOSAFLOOK\*

Vijon nga faqja 13

Këto dy dokumente disa pojnë të dhëna aq interesante dhe të reja, sa që jemi të bindur që do të nxisin ndërmarrjen e studimeve dhe hulumtimeve të reja rreth këtij elbasanasi që e quajmë "babai i gjuhës shqipe". Kështu ilustron përsëri faktin se studimi i Lëvizjes Protestante ndër shqiptarë, ndonëse një fushë relativisht e re në historiografinë shqiptare, na ofron mjaft burime që sjellin fakte të reja për disa nga figurat më të njohura të historisë shqiptare.

Është një fakt mjaft ironik që ky vit, viti i 500-vjetorit të Reformacionit Protestant, është, njëkohësisht, 50-vjetori i shpalljes së Shqipërisë si shtet ateist. I pari Reformacion, ai që kishte si qëllim përkthimin e Shkrimit të Shenjtë në gjuhët amtare të botës, paska bekuar shqiptarët nëpërmjet veprimtarisë letrare, fetare dhe arsimore të të tillëve si K. Kristoforidhi dhe familja Qiriazi. Kurse i dyti "reformacion", ai që kishte si qëllim dëbimin e Shkrimit të Shenjtë nga ndërgjegjia jonë, jo vetëm që i mallkoi shqiptarët që të mos ndriqoheshin me Fjalën e Zotit, por e mallkoi historiografinë shqiptare, duke e detyruar të mohonte rolin kyç dhe të drejtpërdrejtë që Lëvizja Protestante paska luajtur për të mirën e kombit në agimin e rilindjes sonë kombëtare.

Raporti i tretë vjetor i Shoqërisë në Ndihmë të Misioneve në Turqi, për vitin 1856-1857


(fq. 20-21, raport nga qendra e kishës protestante në Smirne / Izmir) Përktheu nga anglishtja prof.dr. Xhevat Lloshi)

Nga qendra e kishës protestante në Smirne/Izmir:]

Sapo janë pranuar tre anëtarë të rinj. Njëri prej këtyre [K. Kristoforidhi] është një shqiptar me arsim laik. Ai është rritur në brigjet e Adriatikut. Në moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare vajti në Universitetin e Athinës, ku qëndroi gjashtë vjet, ndërsa pas kësaj për dhjetë vjet ka qenë në punë shteti në Trieste, prej nga ka ardhur nëntë muaj më parë.

Përkimet e habitshme

Është një fakt mjaft ironik që ky vit, viti i 500-vjetorit të Reformacionit Protestant, është, njëkohësisht, 50-vjetori i shpalljes së Shqipërisë si shtet ateist. I pari "reformacion", ai që kishte si qëllim përkthimin e Shkrimit të Shenjtë në gjuhët amtare të botës, paska bekuar shqiptarët nëpërmjet veprimtarisë letrare, fetare dhe arsimore të të tillëve si K. Kristoforidhi dhe familja Qiriazi. Kurse i dyti "reformacion", ai që kishte si qëllim dëbimin e Shkrimit të Shenjtë nga ndërgjegjia jonë, jo vetëm që i mallkoi shqiptarët që të mos ndriqoheshin me Fjalën e Zotit, por e mallkoi historiografinë shqiptare, duke e detyruar të mohonte rolin kyç dhe të drejtpërdrejtë që Lëvizja Protestante paska luajtur për të mirën e kombit në agimin e rilindjes sonë kombëtare.



Konstandin Kristoforidhi

Ishte i besimit ortodoks, por në kohën që ndodhej në Athinë pushoi së qeni besimtar dhe i tillë mbeti gjatë gjithë kursit universitar.

Megjithatë, kur ishte në Trieste, ndërgjegjia nuk e linte të qetë. Nisi të lexonte autorë teologjikë grekë për të gjetur një arsye për besimin e tyre, por nuk e gjeti. Atëherë iu kthye autorëve katolikë, mirëpo dhe ata i dolën edhe më të pakënaqshëm. Më në fund, pas vitesh të trishtuara, gjeti libra protestantë dhe, duke i lexuar, filloi të shpresonte se kishte siguruar ushqim për shpirtin e vet të uritur. Kur erdhi në Smirne, tashmë ishte mjaft i kënaqur lidhur me autoritetin e zbulësës dhe të së vërtetës së doktrinës protestante, kështu që pas pak kohësh pranoi me vullnet besimin protestant. Kjo kishte ndodhur përpara se të kishte takuar ndonjë misionar ose të kishte biseduar me ndonjë të krishterë ungjillor. Pa kaluar shumë kohë, shkoi të takonte Rev. Zadd dhe pati shumë biseda me të; nisi të ndiqte shërbesat tona dhe pas disa muajsh, shprehu dëshirën që të pranohet në kishë. U pranua pas një provimi të plotë. Për disa muaj kishte shprehur një

dëshirë të madhe që të shoqëronte cilindo misionar për të shkuar

në atdheun e tij, ndonëse tashti është i punësuar me leverdi në



Konsullatën austriake të këtij qyteti. Kjo shtyes, për t'u bërë misionar, kohët e fundit ka marrë formën e përcaktuar të një dëshire që të përkthejë Shkrimet për shqiptarët. Është posaçërisht i përshtatshëm për këtë punë, meqë ka arsim të mirë universitar, nëpërmjet të cilit është kualifikuar një mendje e fortë nga natyra, ka dalë e dëshirueshme që të shtohet një kurs teologjik dhe ne e dërguam në Stamboll (te Seminari Protestant i Bebekut, D.H.) për të vijuar studimet dhe për të kryer përkthimin e tij.

Përktheu nga anglishtja Prof.dr. Xhevat Lloshi)

"LUTHERI E KRISTOFORIDHI"

Gazeta e re, (28 dhjetor 1928)

Duke lexuar artikujt pro e kundër themelimit të Komissë Letrare si mjet të njësimtë të gjuhës sonë, na shkon mendja në historinë e letërsisë së kombeve të kulturuar, si në atë të Gjermanisë. E këtu na del përpara menjëherë fytyra vigane e Lutherit, që u çua kundër kishës romake, kishës latine; e për ta luftuar, nuk u mjaftua të përbuzë shumë fille fetare, por, për të këputur çdo lidhje me kishën latine, kthen Biblën në gjuhën gjermane.

Deri në kohë të Lutherit gjermanët nuk patën një gjuhë letrare, por secili shtet shërbehej në zrym të veta në dialektin e vendit. Lutheri, kur nisi përkthimin e Biblës, zgjodhi dialektin që flitej në Bavari e në Austri, atë dialekt që thirrej "gjermanishte e epërme" (Ober Deutsch). Ky përkthim i Biblës kreu njësimin e gjuhës gjermane, ajo që teksti mbi të cilin gjuha letrare e gjermanëve vuri

themelin; me këtë përkthim të Biblës mori hov përparimi i gjuhës gjermane. Gjermanët, pra, nuk pritën shkrimtarë të shquar e të pikuar nga qielli, sikur do të donte dikush, që me vështirësi që paraqet për ngritjen e Komissë Letrare [dhe] na bën të dërrojme çka s'kishim dashur ta besonim. Duke marrë nëpër mend veprat



e Lutherit, na shkon mendja vetvetiu te reformatorit shqiptar, tek i ndjeri Kristoforidhi, që për të luftuar kishën latine e njëherësh kishën greke të krishterëve shqiptarë, përkthen Biblën në gjuhën shqipe të Elbasanit, si na e kanë lënë në fjalë të urtë stërgjyshat, kur donin të tregonin një gjuhë shqipe të bukur.

Po pse në shqiptarët nuk punuam si gjermanët e nuk u kapëm me Biblën e reformatorit shqiptar? Deri tashti s'kemi mundur, s'na kanë lejuar të huajt; por sot që jemi të lirë e të parvarur, pse nuk themelohemi mbi Biblën e Kristoforidhit? Ç'presim më gjatë? Të mos fusim dyshime, të cilat zënë vend menjëherë në mendje e në zemrat tona e na bëjnë të besojmë se ende s'qen kemi pjekur e forcur në dashuri kombëtare!

Transkriptuar në standard nga David Hosaflook, drejtori ekzekutiv, Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante Korrektio Teuta Toska













A

ARGUMENT

Nga Shpëtim Çuçka

**N**<sup>23.</sup>ë vitin 1971 doli në dritë poema “Komunistët”. D. Agolli ishte dyzet vjeç. Nuk ishte shkrimtar në profesion të lirë, siç edhe mund të kishte qenë me plot të drejtë për meritat e tij jo të zakonshme letrare. Nuk ishte as kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Punonte si gazetar dhe gjente kohën, në orët e ditës të pazëna nga veprimtari të tjera, të merrej edhe me krijimtarinë letrare, pasionin e jetës së tij.

Përse është e nevojshme të vihen në dukje këto të dhëna të thjeshta, kur vjen çështja te poema “Komunistët”? E vërteta është që një ndër temat më delikate të marrëdhënieve shoqërore, temë që nuk para trajtohet as në rrafshin studimor, jo më në publicistikë, por që në mënyrë të thjeshtë ndeshet shpesh në jetën e në bisedat tona të përditshme, është tema e marrëdhënieve shoqëri-individ. Përgjithësisht trajtimi i kësaj teme merr formën: sa i jep individit shoqërisë dhe sa merr prej saj. Me fjalë të tjera, marrëdhënia shoqëri-individ shihet kryesisht në dritën e një materializmi të rëndomtë, vulgar.

Nuk mund të thuhet se shoqëria jonë është shumë më e prekur se shoqëritë e tjera nga ky lloj këndvështrimi, nga kjo lloj trajtuese me doza ku më pak e ku më shumë egoiste. Në të gjitha shoqëritë, edhe ato që mbahen si më të zhvilluarat, rastet e nisjes së qytetarëve nga parimi “merr sa më shumë dhe jep sa më pak” janë ndër më të përhapurit dhe më tipikët. Një ndër këto raste, ai më i popullarizuar dhe – ndryshe nga sa lihet të kuptohet! – jo më i rrezikshmi, jo më i rëndi, është edhe i famshmi dhe famëkeqi korrupsion, prapa të cilit fshihen trajta të tjera edhe më të rënda e më të rrezikshme të zbatimit të parimit të përmendur më lart.


Pa bërë këtu një analizë të mëtejshme të kësaj çështjeje por duke e marrë atë, si edhe botimin e poemës “Komunistët” në vitin 1971, si pikënisje dhe si një këndvështrim të caktuar për ta parë jetën dhe veprën konkrete të poetit në marrëdhëniet e tij me shoqërinë, mund të thuhet pa mëdyshje se Dritëro Agolli ia shpërbleu me sa mundi shoqërisë çdo të mirë që ai pati në jetën e tij të gjatë. Ia shpërbleu pa kursim dhe pa parë majtas e djathtas se ç’ merrnin të tjerët. Dritëro Agolli me jetën dhe veprën e tij tregoi se i ishte mirënjohës atdheut e shoqërisë për mundësinë që iu dha të bënte një jetë të ndershme dhe të pastër, të mbështetur te puna dhe krijimtaria letrare.

Poema “Komunistët” është pikërisht një ndër ato krijime, ku poeti dëshmoi qartazi pëkurimë e tij qytetare, atë pëkurimë, që te ne nuk e gjen dendur ndër njerëzit e letërsisë dhe arteve, nuk e gjen dendur as ndër specialistët me kualifikim të lartë të fushave të tjera, atë pëkurimë qytetare që nuk ndeshet dendur në përgjithësi në historinë tonë.

Ja ç’ shkruan D. Agolli në poemën e tij:

Kalon një kohë  
e duke udhëtuar  
Mes vargjeve e këngëve të mia,  
Tek ju  
qëndroj  
i heshtur,  
Si udhëtar  
i menduar,

Në vitin 1971 doli në dritë poema “Komunistët”. D. Agolli ishte dyzet vjeç. Nuk ishte shkrimtar në profesion të lirë, siç edhe mund të kishte qenë me plot të drejtë për meritat e tij jo të zakonshme letrare. Nuk ishte as kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Punonte si gazetar dhe gjente kohën, në orët e ditës të pazëna nga veprimtari të tjera, të merrej edhe me krijimtarinë letrare, pasionin e jetës së tij.



# “Komunistët” dhe Dritëro Agolli

i kthyer  
tek shtëpia.  
Dhe ndjej  
se ju  
kudo  
më mbani vesh:  
Se ç’këngë ngriti shoku juaj, vallë,  
Tek brodhi  
mal më mal  
e shesh më  
shesh...

Ç’kuptojmë me pëkurimë qytetare? Pikërisht marrjet dhe dhëniet ndërmjet shoqërisë dhe individit. Veprimet dhe qëndrimet e individit që ka arritur shkallën e pëkurisë qytetare udhëhiqen nga dy parime: i pari, që pa shoqëri nuk ka jetë të individit; i dyti, që individit duhet t’i shpërblejë shoqërisë gjithë përpjekjet e kryera prej kësaj për ngritjen e individit në lartësinë e qenies që punon, që krijon.

Vargjet e mësipërme, ashtu si dhe gjithë poema “Komunistët”, përbëjnë një dëshmi poetike të bindjes dhe mesazhit të poetit se në jetë nuk ka vetëm të drejta, por edhe detyra, madje detyrat vijnë më përpara në radhë se të drejtat; nuk ka thjesht detyra dhe të drejta vetjake, por detyrat dhe të drejtat janë shoqërore, realizohen në shoqëri. Në poemën “Komunistët” detyrat dhe të drejtat përjetohej jo thjesht si pjesë e marrëdhënieve shoqërore, por si thelbi i tyre. Ato janë jo thjesht pjesë e jetës, por janë thelbi i veprimtarisë shoqërore, thelbi i jetës. Krejt ndryshe nga ç’ndodh në një shoqëri të shpartalluar, ku sistemi i detyrave dhe të drejtave shoqërore është gjithashtu i shkatërruar dhe paraqitet në trajtën: vetëm të drejta për një pakicë dhe vetëm detyrime për shumicën. Detyrimet për pakicën dhe të drejtat për shumicën janë thjesht deklarime boshë.

Për banorët e sotëm të Shqipërisë edhe këto vargje – ashtu si mjaft vargje të poemave të tjera, që janë sjellë më sipër – ndoshta tingëllojnë të pakuptueshme e të pabesueshme. Madje edhe ata, që e kanë jetuar periudhën, kur shkruante këto vargje D. Agolli, sot ndoshta janë çmësuar nga mbresat dhe mësimet e vjera të asaj epoke. Jeta e sotme ua ka fshirë dhe vazhdon t’ua fshijë përditë çdo gjurmë të punës dhe jetës së dikurshme. Praktikisht po ua fshin çdo kuptim të asaj historie, që është historia e tyre.

Ja disa pamje të kësaj historie:

Nga dolët ju,	tregojnë	vetë	malet,	qipërinë, S’kam qenë	mbretrit	S h -
Tregojnë	rrugët,	sheshet e qyteteve,	varfëritë edhe hallet,	as artist,	as	vjer-
Ku bridhnin	shpinat	peshë e rëndë e derteve,	shëtart;	S’ua kisha falur	poezinë	
Ku shkelle	çizme e huaj	në kalldrëme...	Më mirë	trupin	baltrash	
Nga dolët ju?	Ju s’mbitë	nga mërzhitë	I lodhur,	i munduar	dhe ulok,	
Mes ballosh	në sallone a bankete,	Siç mbijnë	nga mërzhitë	sot	hipitë,	
Që fryjnë	nëpër ishuj	e qytete.				

Një vëzhgim: sot hipitë janë harruar dhe brezi i ri ndoshta as që e di kuptimin e kësaj fjale. E ndoshta dikush megjithatë nuk i jep këtu të drejtë poetit, pasi, ndryshe prej tij, ai mund të ketë mendimin se hipitë nuk mbinë ashtu thjesht nga mërzhitë...

Sot shumëkush mund ta qortojë poetin për poemën e tij “Komunistët”. Mund ta qortojë, por mund edhe ta dënojë. Mund ta qortojë për himnizim, mund ta dënojë për këtë qëndrim të hapur politik. Mund ta dënojë për shumëçka. Poeti përgjigjen e ka dhënë në vargjet e tij:

Vijon



Dje në "Deutsche Welle"

Nga Benjamin Knight

(vijon nga faqja 1)

... Informator Gjerman (BND) Bruno Kahl: "Në vend të një partneri për sigurinë evropiane, te Rusia më tepër kemi një rrezik potencial. Aktori i politikës botërore Rusi është rikthyer, ai do të mbetet një fqinj i paretshëm". Në një referat të mbajtur në Fondacionin Hans Seidel në Mynih, Kahl foli për një modernizim "të habitshëm" të forcave të armatosura ruse.

Ekspertë të sigurisë janë të habitur me fjalët e Kahl-it. Ato janë të pazakonta për një person që i bën rrallë publike mendimet dhe analizat e tij - puna e shërbimeve të fshehta, siç e thotë emri, shumicën e kohës zhvillohet pas perdeve.

"REALIST, PRAGMATIK"

Për Sebastian Schulte, korrespondentin për Gjermaninë të revistës ushtarake britanike "Jane's Defence Weekly", deklaratat e Kahles janë "realiste, pragmatike dhe pasqyrojnë atë që kanë vërejtur edhe vëzhgues të tjerë". "Të gjithë ne nuk flasin sa duhet për sjelljen e Rusisë ndaj Perëndimit, Evropës dhe, para së gjithash, shteteve të Evropës Lindore." Ai tha se veç lajmeve, për luftimet e forcave të mbështetura nga Rusia dhe Ukrainës në medie nuk gjen analiza, "gjë që është e habitshme".

FUQI MBROJTËSE SHBA

Si kundërpeshë ndaj rrezikut rus për Evropën, Kahl paraqiti në fjalimin e tij bashkëpunimin me shërbimet e fshehta të SHBA dhe, para së gjithash, me ushtrinë e SHBA. "Ata kanë mbi dhjetë aeroplanmbajtëse, të cilat mund t'i dërgojnë brenda kohës më të sh-

# Rusia: E vlerësuar drejt si rrezik?



kurtër në zonat ndërkombëtare të konfliktit", tha shefi i BND-së. Rëndësi ka që të pengohet që Kremlin të ketë sukses "në dobësimin e BE, në spostimin e SHBA dhe veçanërisht që të futet një pykë midis të dyve".

Mark Galeotti beson se vëzhgimet e Kahlit në përgjithësi janë të drejta, por megjithatë e pikturojnë "tepër errët" realitetin. Ek-

sporti për politikën ruse të sigurisë dhe drejtori i Qendrës për Sigurinë Evropiane në Institutin për Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Pragë tërheq vëmendjen se Rusisë i duhet ende shumë për të arritur Perëndimin.

"Të paktën gjysma e ushtrisë ruse nuk është e modernizuar si duhet", thotë ai. Dhe shton se "vetëm shtetet anëtare të NATO-s,

pa SHBA dhe Kanadanë kanë më shumë trupa tokësore se Rusia". Galeotti arrin në përfundimin se Rusia, e parë në mënyrë realiste, mund të mobilizojë në çdo kohë 50.000 vetë. "Kjo nuk është Ushtria e Kuqe sovjetike", thotë ai. "Kjo nuk është një fuqi që mund të sulmonte Evropën Perëndimore, që mund të matej me NATO-n me shpresën për të fituar".

MONIKA SHOSHORI STAFIA

→ vijon nga faqja 21

variant femëror i Luterit. Përveç që ishte e bukur, me mollëza të dala dhe një vështrim të drejtpërdrejtë ajo dukej se nuk i kishte kaluar të pesëdhjetat. Dukej miqësore, e gjithashtu, me sa duket e kishte kuptuar që unë po tallesha në mendjen time me një regjim që u kërkonte shtetasve të vet të nënshkruanin garanci besnikërie që ngjanin si certifikata martesore; që konfiskonte kartolinat e ditëlindjeve që fëmijët ua dërgonin gjyshërve; dhe që shkruanin protokolle të pakuptimita në tryeza poshtë kalendareve me gra gjoksmëdha. Kjo ishte frau Troster, që kujdesej për muzeun. Frau Troster më shpjegoi se ajo letër ku isha përqendruar ta deshi-froja ishte pikërisht një letër garancie për besnikërinë që qytetari X i nënshkruante Stas-it. Pak më vonë ajo më tregoi dhe një histori gruaje, bashkëshorti i së cilës kishte vdekur teksa mbahej i arrestuar në një qeli të Stas-it, aty pranë. Atëherë rrëfente ajo, u hap fjalë se Stasi e kishte orkestruar vetë funeralin deri në atë pikë sa e zëvendësoi arkivolin e zbrazët me një të plotë dhe e dogji kufomën për të

shkatërruar çdo dëshmi të shkakut të vdekjes. Pas kësaj përpiqesha ta merrja me mend se çfarë do të thotë të mos dish nëse bashkëshorti yt varri veten apo nëse dikush me të cilin, ti shkëmbehesh në rrugë e vrau atë.

EPILOGU

Mitin e kujtesës në Gjermani



nuk e sheh vetëm në zyra të ndorimit të burimeve të shkuara, në institucione, por edhe në trotuare. Kudo ka shenja për njerëz e ngjarje të kohës së luftës e të pasluftës, të periudhës së ndryshimeve politike. Vetë muri i Berlinit është kthyer në kujtesë materiale, gati-gati në bizhuteri. Vendësit na thonë se gjithë muri i Berlinit tan-

imë është shitur, ndoshta është shitur dhe për herë të dytë a të tretë. Megjithatë, te portat e Brandenburgut vazhdimisht ka turistë që blejnë gurin historik, megjithëse e dinë se ai i Berlinit ka mbaruar. Në Berlin nuk mund të thuash se e ke parë sadopak të shkuarën pa vizituar murin, ku mund të njihesh me tmerre të përbindshme: gra shtatzëna që janë hedhur nga kati i tretë për të kaluar në "Gjermaninë tjetër"; të rinj e pleq që kanë humbur gjysmën e familjes për të kapërcyer kufirin, dënime makabre për tentuesit e arratisjes. "Lufta e ftohtë" me sa duket këtu ia ka kaluar kloneve shqiptare. Por ndryshe prej Shqipërisë, ku sot është vësh-tirë të gesh jo një copë nga telat e elektrizuar të klonit, por dhe shen-jat e piramidave vetë, në Gjermani tmerret e murit që ndau një popull në dy shtete e dy kampe njëherësh, mund t'i shohësh të certifikuara në foto, shkresa të panumërta, gazeta, deri dhe në imazhe të filmuara që ndoshta janë produkt i kamerave të sigurisë, që shteti i blinte për të mbikëqyruar murin.

**HOROSKOPI**

**DASHI**  
Me partnerin gjithmonë gjeni diçka për të qeshur, sidomos nëse vjet vënë në dukje dallimet tuaja, si në kuptimin e karakterit ashtu edhe të synimeve. Të paktën Hëna flet gjuhën tuaj: vitalitet, besim dhe zgjidhje të shpejta.

**DEMI**  
Koha që i kushtoni estetikës personale si dhe rehatisë në shtëpi ju relakson, ju vë në paqe me veten tuaj dhe ata që ju rrethojnë. E diel intime dhe e përzemërt, larg qdo angazhimi, nxitimi dhe zhurmës së njerëzve.

**BINJAKET**  
Nuk ka asgjë të keqe nëse doni të qëndroni të vetëm, edhe pse në një këndvështrim afatgjatë, vetmia nuk do t'ju bënte fare mirë. Përpiquni të hyni në lojë. Duke qenë aktivë, do të përjetoni më shumë çaste të mbushura me emocione.

**GAFORJA**  
Partner kokëfortë, nëse i shtoni edhe familjen luftarake dhe komshinjtë e zhurmshëm, do përpiqeni shumë të merrni situatën në dorë këtë të diel. Të irrituar edhe ju për shkak të zgjimit shumë herët në këtë ditë pushimi.

**LUANI**  
E diela i plotëson mjaftueshëm pritshmëritë tuaja. Jeni në humor të mirë dhe një drekë e mirë do vlerësohet shumë nga familjarët tuaj. Ndoshta mund të vendosni të kaloni pak nga koha e juaj e lirë në aktivitetet sociale.

**VIRGJERESHA**  
Hëna në kuadraturë me Neptunin drejton gishtin mbi raportet familjare dhe ato në çift, duke vënë në dukje ndonjë mangësi emocionale dhe duke shkaktuar tension. Sidoqoftë, duke vënë në punë sensin tuaj praktik do arrini të mbani situatën nën kontroll.

**PESHORJA**  
Hënë miqësore dhe aventureske, shpresojmë që do arrijë të mbajë nën kontroll Marsin e zymtë që përplasat me Plutonin, duke shkaktuar tensione në familje. Mos humbisni shpirtin luftarak nëse nuk ndjeheni të mbështetur në objektivat tuaja.

**AKREPI**  
Hënë e shkëlqyer për biznes por jo për zemër: kurrë mos ngatërtoni financat me ndjenjat, edhe krijimtaria humbet në raste të tilla. Në lidhje me një vendim të rëndësishëm, mos pranoni këshilla nga persona që nuk kenë shumë kohë që i njihni.


**SHIGJETARI**  
Hëna protagoniste në shenjë, po për fat të keq përplasat me Neptunin që ngatërton emocionet dhe krijon disa probleme të panevojshme në shtëpi. Ndjenja dominuese është që të kuptoheni nga të tjerët. E doni shumë familjen tuaj, por e ndjeni të largët.

**BRICJAPI**  
Çdo gjë ju nevrozon dhe ju irriton sot. Partneri ndonjëherë ju bën të ndjeheni xheloz, ndonjëherë ju bën të keni zili, ndjenja që nuk kanë shumë lidhje me ju. Nën presion raportet familjare, kini kujdes nga ndonjë grindje e ekzagjeruar me prindërit.

**UJORI**  
Në plan të parë miqësia! Bashkëpunim maksimal si me partnerin ashtu edhe me miqtë tuaj: kuptoheni me një shikim. Të gjitha aktivitetet e organizuara bashkë do realizohen për mrekulli.

**PESHQIT**  
Hënë tekanjoze në kuadraturë me Neptunin: është humori që dominon zgjedhjet tuaja, të cilat duhet të jenë intuitive, por jo siperfaqësore. Kushtoni pak kohë vetes tuaj: gëdhje, art dhe muzikë.

**Fjalëkryqi (1)**



HORIZONTAL

1. Mund të jetë kursimi.
5. Ylli i Nostradamus.
8. Tamam pa kufij.
11. Ross këngëtare.
13. I lashtë.
15. Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
19. Kufijtë e lëvizjes
20. I ka tek plepi.
21. Paguhen për shërbim.
23. Fillojnë lejen.
24. Kufizojnë troutaret.
25. Bëjnë karrierë në parti.
27. Thahet me bonifikim.
28. Mund të jetë unik një i tillë .
29. Preka komik shkrdran.
31. Fund dhjetori.
32. Fillojnë aksionin.
33. Ente Operative Tiranë.
34. Agjenci Ajrore Durrës.
36. Një pjesë e dimensioneve.

VERTIKAL

1. Si i përshtatëshëm.
2. Mund të jenë fetare.
3. Ai i kuq e ka një huq.
4. Pak analogji.
6. Eshhtë metri i rrobaqepësit.
7. Një hyrje të oazit.
8. Arte pa re.
9. Arthur që qe dramaturg.
10. Janë boshte.
12. Michelangelo regjisor.
14. Mund të bëjë stil të lirë .
16. Ishin monedhe të Tobias.
17. Eshhtë bas me katër tela.
18. Pak efikasitet.
22. Eshhtë marrëveshje me nota.
25. Ishite babai i Akilit.
26. Fillojnë nazet.
27. Në krye të kuadrove.
29. Eshhtë faqe muri.
30. Një apendisit i menjëhershëm.
35. Kurosawa që qe regjisor.
36. Writen nga espada.
37. Eshhtë shtet aziatik.
38. Edouard piktor.
40. Një transporti është kamioni.
45. Uni i Freud.
46. Një cigan.
47. Fundi i një samurai.


**Fjalëkryqi (2)**

HORIZONTAL


1. Fillojnë panikun.
3. Gibson aktor.
5. Në mes të cogito dhe sum e thën nga Des-cartes.
9. Mund të jetë trofe.
11. Janë vendet si Katari
14. Maureen që qe aktore.
16. Janë kundërmuese.
17. Mund të fitojnë etapa.
20. Ushtojnë nga "ola".
22. Një thirrje
26. Janë ministritë.
27. Një rrugë në Paris.
28. Markë cigareje.
29. Eshhtë nginjia.
32. Ricciarelli soprano.
33. Fillojnë sefte.
34. Ente Ekonomike Sarandë.
35. Mbyllin një ditari.

VERTIKAL


1. Një votë në favor.
2. Filozofi me eksperimentin e gomarit.
3. Një hyrje makinës.
4. Fillojnë lehtë.
5. Irlanda në Dublin.
6. Eshhtë edhe ajo e historisë.
7. Një pjesë e gamiljeve
8. Notat pa kufij.
9. Ishin komitë.
10. Ka kryeqytet Islamabad.
12. Don... i Interpretuar nga Terence
13. Mbyllin aktet.
15. Janë përmasa.
18. Gjysma e lutjes.
19. Castellitto aktor.
20. Inicilat e Dali, piktor.
21. Tanita këngëtare.
23. Eshhtë tryzni
24. Një hyrje të Europës.
25. Janë rrobrot për t'u larë.
30. Bën mëza.
31. Moreau aktore.
32. Janë thika.
39. Një pjesë e satelitit.
40. Janë teke në sende.
41. Pak marramendëse.
42. I ka tek zdapi.
45. Iniciale e Nolte-s.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

A V A T I S A L A M I N A  
 L A N A F E A R I S  
 A L E N E N A P T O P  
 I E G E R S I R A T B I  
 N E A S M O D E U M I R  
 S A M T A R A F F A  
 M R O N I N O M A R E A  
 H A B E R T O M A R E A  
 R I T T S E R I T E T  
 T E M E B E L I V T  
 O T M E R I T A S A M  
 M A R I A N A A R M A N I  
 M A R N I E P R M I T E  
 I N A T U M A D T E S  
 S T U S E N D E R E A  
 T E L T U N D I M I A U  
 E N K E N D I M I S A  
 R A A F J O E B E L A  
 I T A A A N N A K I I  
 O K A N A I S A R N A  
 Z E L L T I S M E D A  
 E T B A R I T O N T I O R  
 T O K A A L L E R A  
 M I N I M A L E S T E R

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



**SUDOKU**

	2		7		8			
3								1
		8	1	3	4			
9	3		6	2	7	4		
			7	4				
1	4		3	5	2	6		
		9	2	1	5			
7								9
	5		6		4			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	5	3	8	7	1	4	6	9
9	1	4	6	5	3	7	8	2
8	6	7	2	9	4	5	1	3
4	9	1	7	8	5	3	2	6
7	2	5	9	3	6	1	4	8
3	8	6	1	4	2	9	5	7
5	3	9	4	6	8	2	7	1
6	4	2	3	1	7	8	9	5
1	7	8	5	2	9	6	3	4

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2	7	3	13	2	
2	7	5		8	4	3	5	7
7		3	1	9	1	6	5	10
	3	5	8	2	3	5	6	1
12	5	13	5	10	1	7	6	13
2	7	18	5	11	2	6	5	8
8	2	6	2	2	2	1	8	5
1	6	8	17	9	5	7	2	9
3	1	5		8	2	16		2
2			3	2	6	5	9	2
6	2	7	2		3	7	18	3
3	4	8	5	19	1	5	3	5

T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H	
O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E	
G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T	
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
R	S	L	R	E	T	E	R	I	K		
P	E	L	O	T	A	D	V	E	M	A	
S	O	T	R	T	A	R	E	E	T		
T	R	G	P	A	R	E	T	E			
E	T	L	A	R	I	T	M	I	A		
F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A	
A	D	I	T	E	T	T	O	M			
N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

*Argëtim filozofik*

**MJESHTRI MAGJIK, DA VINÇI**

- Më pëlqejnë ata që mund të buzëqeshin në telashe, ata që mund të fitojnë fuqi nga stresi dhe që bëhen të zotë, duke reflektuar.
- Mendjet e vogla tkurren, por zemrat e mëdha me ndërgjegje për veprimet e tyre, u përmbahen parimeve deri në vdekje.
- Teksa mendoja se po mësoja si të jetoja, paskam qenë duke mësuar si të vdes.

*Thënie të mëncura*

- "Bota është një vend i rrezikshëm për të jetuar; jo për shkak të njerëzve që bëjnë gjëra të këqija, por për shkak të njerëzve që i shohin ata dhe nuk bëjnë asgjë."
- Barinjët do të jenë brutalë, sa kohë që delet të jenë budallage. (E. Godin)
- Eshhtë më e thjeshtë të gjykosësh naivitetin e një njeriu nga pyetjet, se sa nga përgjigjet e tij. (Duc De Levis)

-Albert Einstein

(Duc De Levis)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

